

Solicitors Regulated By



Solicitors Regulation Authority



BRITISH PASSPORT

BRITISH PASSPORT

UNITED KINGDOM OF GREAT BRITAIN AND NORTHERN IRELAND

AVOKATË EKSPERTË NË IMIGRIM

Morgan Hill Solicitors SPA No. 069884

NO WIN NO FEE*

Contact us on +44 203 9300 553
Kontaktoni **Genin** në Shqip në **+44 777 85 86 335**



Gjeni më shumë informacione në fq.7 dhe fq.9

*Subject to Terms And Conditions

The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 25 QERSHOR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

SONDAZHET TRONDITIN SUNAK! PARASHIKOHET HUMBJE E RËNDË PËR KONSERVATORËT



PETRIT KUÇANA

**KU HUMBI "E
GJITHË VËMENDJA
PËR DIASPORËN" ?**



ARBEN MANAJ

**REKORD I RI! ANGLIA "NË DËSHPËRIM",
BRENDA DITËS
900 EMIGRANTË
NGA DETI**

IMAZHI I SHQIPTARIT

DAUT DAUTI




SHUMË IDIOTË, NË NJË METËR KATRORE!

KIM MEHMETI




TRURI KOLEKTIV QË DUHET NDRYSHUAR!

IRENA BEQIRAJ




HUMBËM NDESHJEN, POR FITUAM EKSPERTË

LUTFI DERVISHI



DUKE PRITUR PRESIDENTIN, TASHMË TË PARË, AMERIKAN

VETON SURROI



POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

“Ditët e Diasporës” vazhdon të mbetet një sllagan i munguar në Shqipëri, e mbase mund të konsiderohet edhe si tepri, nga shumëkush i fokusuar në përditshmëritë politike. Kushedi si mund të ngjajë një kërkesë tepër e thjeshtë që edhe Shqiptaria të ketë “Ditët e Diasporës” pikërisht në kohën kur qindra mijëra shqiptarë kthehen me pushime në mëmëdhe. Pushteti qendror apo vendor do të

mjaftonin të kthenin sytë nga Kosova dhe do të shikonin se, jo vetëm që është terësisht e mundur organizimi i Ditëve të Diasporës, por se kjo është një domosdoshmëri.

Është një traditë e konsoliduar në Kosovë, ndërsa nga Shqipëria mjaftohen me ndonjë lajm për numrin e të ardhurve, për shifrat e dërguara nga mërgimtarët, e gjithçka tjetër përveç asaj që mund të bëhet për diasporën. Ka një raport goxha të komplikuar mes qeverisë shqiptare dhe Diasporës. Do të ishte bukur e mundimshme rikujtimi i “E gjithë vëmendja për diasporën” ato samitet e famshme të diasporës, që as përkrahësit më të thekshëm të qeverisë dhe kryeministrit, nuk mund të gjejnë një nuancë pozitive që mund të kenë prodhuar, të famshmet Samite të Diasporës. Ato u

harruan shpejt edhe pasi përmbushën tre-ditëshin e lajmit, ashtu siç u harrua ngrenia e vetme institucionale që kishte të bënte me diasporën, që u rrafshuan brenda natës, sa hap e mbyll sytë, krejtësisht e papërfillshme edhe si lajm, e ashtuquajtura Ministria e Shtetit për Diasporën.

U harrua Diaspora, e madje duket krejtësisht një shpërfillje që shkon gati gati në tallje, përbuzje.

A ka dikush që mund t’i kërkojë institucioneve të shtetit shqiptar të zbatojnë ligjet në fuqi, të paktën për diasporën, që duhet tu skuqet fytyra, ndërsa do tu kujtohen ato premtimet për diasporën e deri tek garancia për të drejtën e votës në vendet ku jetojnë?

Është e pamundur që të imagjinohet që pushteti qendror të përqëndrojë për

një ditë të vetme, vëmendjen tek diaspora, në këto ditë vere. E pamundur që të mendohet që bashkitë nëpër Shqipëri t’u kushtonin një gjysmë dite diasporës. Tashmë zgjedhjet kanë mbaruar.

(Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi propozimin e Këshillit të Ministrave për ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. 24/06/2019 Në çdo bashki do të ngrihet një strukturë e veçantë për çështjet e Diasporës dhe migracionit që do të ketë si fokus forcimin e komunikimit dhe marrëdhënieve me komunitetin e shqiptarëve në Diasporë. Gjithashtu do të bëjë të mundur nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm në ndihmë dhe mbajtjen e

komunikimit dhe forcimin e marrëdhënieve me Diasporën shqiptare. Në këto zyra të posaçme prioritet do të jetë dhënia e ndihmës dhe e informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu do të ofrohet informacion për të interesuarit nga Diaspora dhe migracioni për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve.)

E mbase dikush do të skuqet, thjesht të skuqet tek kujton çfarë premtime për diasporën, e mbase mbase do të kujtohen se po mund të bëhët diçka qoftë edhe locale.

“E gjithë vëmendja për diasporën” mbetet tallja më e madhe me mërgatën shqiptare. **RIBOTIM**

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARET NË UK


Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER
SPONSORSHIP LICENSE

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Më shumë se 880 emigrantë me 15 gomone e varka të vogla kanë mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar brenda një dite të vetme përmes La Manshit, një rekord i ri ky që shton presionin mbi kryeministrin Rishi Sunak përpara zgjedhjeve të përgjithshme të 4 korrikut, në një kohë kur çështja e emigracionit të paligjshëm është prej pikave më të nxehta të kësaj fushate. Shifrat e fundit të Home Office përbëjnë totalin më të lartë ditor që nga tetori 2022, kur mbi 1.000 klandestinë hynë në ujërat e Mbretërisë së Bashkuar brenda një dite.

Dhe kjo, pikërisht në një kohë kur qeveria e Sunak ka ndërmarrë masa

REKORD I RI! ANGLIA “NË DËSHPËRIM”, BRENDA DITËS 900 EMIGRANTË NGA DETI

njëra pas tjetrës me shpresën të frenojë fenomenin që mund t'i kushtojë shtrenjtë në zgjedhje. Në mesin e këtyre masave është edhe ndalimi i bërë emigrantëve që mbërrijnë në Britaninë e Madhe për të aplikuar atje për azil, ndërsa është diskutuar gjatë çështja e dëbimit në Ruanda, nismë kjo e cila ende nuk është vënë në zbatim.

Në mbi gjashtë vitet e fundit, gati 130 mijë emigrante kanë hyrë në Mbretërinë e Bashkuar përmes La Manshit. Home Office thotë se po “vazhdojnë të punojnë ngushtë me partnerët francezë për të parandaluar kalimet e paligjshme dhe për të shpëtuar jetë.” Shumë sondazhe opinione tregojnë se zgjedhjet e përgjithshme të 4 korrikut mund t'i japin fund 14 vitesh qeverisjeje të Partisë Konservatore në Angli.

Sondazhet tronditin Sunak! Parashikohet

humbje e rëndë për konservatorët

Kryeministri britanik Rishi Sunak parashikohet të jete i pari kryeminister ne detyre qe mund te humbas ne zonen e tij elektorale dhe te mos jete me deputet ne historine e politikës britanike! Sipas nje sondazhi te botuar nga Daily Telegraph nje gazete shume prane qeverise se qendres se djathte, konservatorët e tij qe ndodhen ne

pushtet prej 14 vjetesh pritet te fshihen nga harta politike ne vend! Kjo parti, me e vjetra ne Britani rrezikon te marr vetem 53 deputete ku tre te katertat e ministrave te kabinetit qeveritar nuk do zgjidhen me dot deputet.

Sipas Daily Telegraph laburistet e qendres se majte pritet te marrin 516 deputete ose nje shumice prej 382 deputetesh ose dyfishin e deputeteve qe fitoj Toni Bler ne 1997-en. Nderkohe

partia e Reformes ose ish partia e Brexit me kryetar Nigel Farage edhe pse me mbeshtetje jo te vogel, por per shkak edhe te sistemit zgjedhor rrezikon te mos marr asnje deputet dhe kryetari i saj te deshtoj pas 8 tentativave per tu bere deputetet ne parlamentin britnik.

Ekspone te larte te partise ne pushtet ne narativen e tyre elektorale keto dite te vetbindur ne humbjen katastrofale qe i pret, me shume po perqendrohen ne minimizimin dhe frikesimin e elektoratit se nese fitojne Laburistet kaq thelle, ata do jene parti e perjetshme ne pushtet, edhe pse opion i pabesueshem ne nje demokraci si kjo britanikja!

Nese konservatorët britanik do pesojne kete humbje qe parashikohet nga sondazhet ku asnje prej tyre ne dy vitet e fundit nuk i nxjerr ata fitues, kjo do te jete humbja me e thelle ne 200 vjetet e fundit te nje partie politike si Partia Konservatore, partia me e vjeter ne Britani dhe e dyta me e vjetra parti politike ne bote!



KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk



Për shitje

Mob:
07939484609

Mbi 15 vite Lease

**I pajisur me te gjitha
licensat**


**Lokali eshte i hapur
prej vitesh me klientele
te garantuar**

**Mundesi fantastike
per zgjerimin e biznesit**

**Çmimi teper i favorshem
Per me shume info
na kontaktoni
Mob:
07939484609**

Një ndër lokalet më të frekuentuara në Walthamstow





DAUT DAUTI

Ky është një fotomontazh i përgatitur nga një portal kroat me titull 'Lukica' pasi që është fjala për Lluca Modriqin, futbollistin legjendar kroat, i cili për disa njerëz (kroat) nuk ishte në formë të duhur.

Fotografia, që ka motiv hakmarrje ndaj Modriqit, ka një prapavijë raciste ndaj shqiptarëve. Lluca Modriq nga disa shihet si njeri i vogël, shëndetlig dhe mbi të gjitha i shëmtuar.

Ky ka qenë imazhi i shqiptarit në ish Jugosllavi, apo në tërë Ballka-

nin që e ka ndërtuar ideja pansllave dhe ortodokse dhe e cila shqiptarit ia shton edhe elementin e varfërisë, egërsisë, agresivitetin dhe injorancën.

Përafërsisht kësaj ideje i kanë ndihmuar edhe vet shqiptarët në ish Jugosllavi duke qenë të shtypur dhe Shqipëria duke qenë e izoluar.

Tashti gjërat kanë ndryshuar dhe këta popuj po e shohin që shqiptari nuk është nën ta, por sikur ata e bile në disa raste edhe mbi ta.

Kjo ideologji e ndërtuar me shekuj nuk e duron shqiptarin e barabart e lëre më mbi ta. Këtu duhet shumë punë në literaturën shkollore dhe në mediat e vendeve fqinje të shqiptarëve. Por, këto vende, përjashto Kroacinë dhe Slloveninë, duket që nuk

IMAZHI I SHQIPTARIT



e kanë ndërmend ta ndryshojnë këtë qëndrim fashist ndaj shqiptarëve.

Patriotizmi

Akti i Mirlind Dakut është i papranueshëm. Dëshira për t'u paraqitur patriot në Kosovë është

një problem kompleks. Është një frymë e panevojshme që bartet në të gjitha shtresat shoqërore e profesionet që nga bujku, zanatlinjtë e ndryshëm e deri të 'intelektualët' dhe politikanët. Situata mund ta arsyetojë këtë gjendje, por jo edhe përmasën e patriotizmit që shfaqet gjithkund, përfshirë fushën e futbollit.

Megjithatë, sulmet që po bëhen kundër Dakut në media dhe komentet kundër tij, janë poashtu të papranueshme dhe janë ekstremisht jopatriotike. Madje, disa media dhe komentues, zakonisht të Shqipërisë, kanë kërkuar përjashtimin e Dakut nga kombëtarja. Si është e mundur kjo gjë?

Nga injorantët Daku akuzohet edhe për faktin se nuk mund të

jëtë patriot për shkak se luan për një klub rus, e cila gjë nuk është e vërtetë. KF Rubin Kazan është ekip i Tataristanit, që është pjesë e federatës ruse. Por, tatarët nuk janë rusë. Tatarët kanë një histori të gjatë të angazhimit në luftë kundër tendencave shoviniste ruse.

Tataristani, që dmth shteti i tatarëve, daton që nga shek. VI por kur ky vend ra në sundimin rus në shek XVI, gati qe shkatërruar tërësisht qenja tatarë. Rusët e dogjën Kazanin deri në themel, i vranë, i përzunë dhe i konvertuan me dhunë në ortodoks më shumë se gjysmën e tatarëve të Volgës kurse atyre që mbetën ua ndaluan fenë myslimane. Është çudi se si kanë mbijetuar tatarët. Kjo është për shkak se ata janë popull luftarak dhe nuk dorëzohen.

Ta akuzosh Dakun se luan në një klub rus, është sikur ta akuzosh dikend nga KF Prishtina se ka luajtur në një ekip serb për shkak se klubi garonte në federatën e futbollit jugosllav.

HYSAJ E ULI KOKËN PARA TOPIT, POR JU QË E ULNI KOKËN PARA PUSHTETIT!

SONILA MEÇO

Do behet ky vend, po mor po do bëhet, por kur numri i statuseve, komenteve, shfryrjeve, indinjimeve, reagimeve për si uli kokën Hysaj, mbrojtës skuadre për t'i lënë rrugë të lirë 'ngrënies' së dy golave në portën tonë, të jetë barabar me atë të njerëzve të indinjuar në rrugë e sheshe për si ul kokën pushteti përballë mafies e

krimit të organizuar për t'i lënë rrugë të lirë 'ngrënies' së jetës së çdo shqiptari n'tokë t'vet.

As mos më thoni s'ka vend krahasimi, se futbollit është adrenalini, qejf e arrati nga stërmundimet e ditës, sepse shqeto thënë, është bast edhe më i parëndësishëm se ai ku në lojë është krejt çfarë ke bërë e sakrifikuar në jetë.

E për më tepër kur bash ashtu, kokëulur me pasoja shumë më të rënda ngajmë tekna na shpartal-



lojnë goditjet e kundërshtarit më të madh sot për sot në 'lojën' e jetës, pushtetit.

Hysaj mandej lau ndoshta edhe karmën e kujt mbështeti politikisht, por nuk është ai arkitekti i humbjes sonë më të madhe, ndaj nuk meriton më shumë gurë linçimi se çdo kokë 'e ulur' shqiptari, që lejon 'golat' në 'portën' ku luhet rezultati i jetës së vet. E ku kundërshtar nuk ka Bastonin e Italisë, por 'bastunin' e Shqipërisë.

KIM MEHMETI

SHUMË IDIOTË, NË NJË METËR KATRORË!

Lexova diku se Kryetari i Pejës paska shpërfaqur dyshime se vet Policia e Kosovës vendos armatim në Veri dhe më pas e konfiskon?!

Siç lexova se policia e Kosovës paska arrestuar dy shqiptarë të dyshuar për spiunazh dhe bashkëpunim me Shërbimin Sekret të Serbisë, 'BIA'-n.

Pastaj, cilëndo portal që ta hapësh, do përballësh me të njëjtën pyetje: është apo jo Shqipëria narko-shtet?!

Pra çdo kund lajme në kufi me të pabesueshmes, e që ndodhin nëpër 'Shqipëritë' tona!

Ndërkohë të duket se të gjithë harrojmë se Shqipëria është shtet 'anormal' në duart e një kryeministri 'jonormal' si dhe, vend fatkeq, por fatkeqësia e të cilit nuk është vetëm 'Rilindja', por edhe prostitucioni mendorë i elitave shqiptare, elita që defilohet nëpër media dhe ushqehen e majmen nga grazhdi të cilin ua mbush Piktori.



Siç harrojmë se Kosova është një shtet i ri në të cilin të moçme janë vetëm rrënjët e strukturave proserbe dhe jugonostalgjike!

Pra siç harrojmë se 'Shqipëritë' tona janë shumë të vogla, për aq shumë idiotë në një metër katrorë!(KM)

UNICEF: 47% TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI NË VARFËRI USHQIMORE! VENDI YNË LË PAS VETËM TAXHIKISTANIN NË EUROPË DHE AZINË QENDRORE

Të dhënat e UNICEF për varfërinë ushqimore të fëmijëve në Shqipëri janë alarmante. Botimi i fundit "Varfëria ushqimore në fëmijërinë e hershme" tregon se Shqipëria ka 18% të fëmijëve poshtë 5 vjeç të privuar rëndë nga dieta ushqimore dhe 29% e fëmijëve janë në varfëri të moderuar (Total 47%).

PASIGURIA-NE-USHQIM

UNICEF kategorizon si privim të rëndë ushqimor fëmijët që ushqehen me dy ose me pak lloje ushqimesh në ditë, ndërsa me varfëri të moderuar ato që ushqehen me më pak se 4 lloje ushqimesh.

Krahasimi global i UNICEF tregon se Shqipëria ka përqindjen më të lartë të fëmijëve që jetojnë në varfëri në Europë dhe Azinë Qendrore, pas Taxhikistanit.

Në renditjen globale, Shqipëria pozicionohet shumë keq me varfërinë e fëmijëve, duke lënë pas edhe vende që kanë kaluar luftëra si Iraku dhe vende afrikane si Kenia, Çadi, Ruanda etj.

UNICEF vlerëson se varfëria ushqimore dëmton të gjithë fëmijët, por është veçanërisht e dëmshme në fëmijërinë e hershme, kur ushqimi i pam-



jaftueshëm mund të shkaktojë dëme si në rritjen fizike dhe në aftësitë e zhvillimit mendor. Pasojat mund të zgjasin gjatë gjithë jetës.

Fëmijët e privuar nga ushqimi i mirë nën moshën 5 vjeç mësojnë më pak në shkollë dhe kanë kapacitete më të ulëta të produktivitetit në moshën madhore, duke i futur ata dhe familjet

e tyre në një cikël varfërie të vazhdueshme.

UNICEF sqaroi se baza e të dhënave për ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël u krijua nga sondazhet e kryera në 137 vende dhe territore dhe përfaqësojnë më shumë se 90 përqind të gjithë fëmijëve në rang global.

Renditjen më të mirë në vendet në zhvillim dhe të varfra e kishin Bjellorusia dhe Serbia, të cilat kishin vetëm 1 dhe 2% secila të fëmijëve në privim të rëndë ushqimor.

Varfëria ushqimore e fëmijëve matet duke përdorur dietën e UNICEF-it dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Për të përmbushur di-

versitetin minimal të dietës për rritje dhe zhvillim të shëndetshëm, fëmijët duhet të konsumojnë pesë nga tetë grupet e përcaktuara ushqimore.

Mes fëmijëve që jetojnë në varfëri të rëndë ushqimore, katër në pesë fëmijë ushqehen vetëm me qumësht gjiri dhe/ose produkte qumështi dhe/ose një lëndë bazë nisështje, si orizi, misri ose gruri.

Më pak se 10% ushqehen me fruta dhe perime dhe më pak se 5% ushqehen me vezë, ose mish, shpendë dhe peshku. Ndërkohë, ushqimet dhe pijet jo të shëndetshme konsumohen në përqindje alarmante të fëmijëve që jetojnë në varfërinë e rëndë të ushqimore.

Analiza e UNICEF identifikon si shtytës kryesor të sëmundjeve të rënda varfërinë ushqimore të fëmijëve. Varfëria e rëndë ushqimore e fëmijëve shkaktohet nga mjediset e varfra dhe praktikatat e këqija të të ushqyerit./Monitor



Zyrë Avokatie me 15 vite Eksperiencë

If you are getting deported, we will get it sorted!

Kompania jonë specializohet në çështje emigracioni me fokus tek Shqiptarët.

Eksperiencë me mbi 10,000 çështje dhe normë të lartë suksesi.

Skuadra përbëhet nga ekspertë të fushës të cilët kanë ndihmuar Shqiptarët prej 15 vitesh.

Për më shumë info kontaktoni Genin në Shqip: +44 777 85 86 335

Solicitors Regulated By



Mund të vini në këmbë nga këto stacione:



Bank, Liverpool Street,
Monument, Aldgate,
London Bridge.
EC3V 4AB City Office



+44 203 9300 553

ARTE Home Furniture

NOW OPEN




%20

WITH THIS
VOUCHER



Address: 1 Aldermans Hill, London N13 4YE

0 7447 992436

 [artehomefurniture](#)

 [artehomefurniture](#)

 info@artehomefurniture.co.uk

REL

Gjenerali i pensionuar amerikan, Wesley Clark, është nderuar të dielën në Prishtinë me dekoratën “Dr.Ibrahim Rugova” nga Lidhja Demokratike e Kosovës [LDK], për rolin e tij në çlirimin e Kosovës.


Clark ka udhëhequr fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe më 1999.

Fushata e sulmeve të NATO-s, e cila ka zgjatur 11 javë, është kryer për të ndaluar dhunën e forcave serbe kundër shqiptarëve në Kosovë.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se emri i Clark-ut është i ngulitur në themelet e krijimit të historisë së Kosovës, dhe e ka falënderuar për mbështetjen e ofruar ndër vite.

“Në momentet më të errëta, në synimet tona për liri, vendimet tuaja na kanë dhënë shpresë dhe forcë. Udhëheqësia juaj gjatë intervenimit të NATO-s, ka qenë pikë kthese. Ajo nuk ka ndryshuar vetëm historinë tonë, por ka shpëtuar jetë të panumërta”.

GJENERALI CLARK NDEROHET ME DEKORATËN “DR.IBRAHIM RUGOVA”



EMRI/ Makina u shkatërrua e gjitha, aksident tragjik në në Greqi, humb jetën 25-vjeçari shqiptar

Abdixhiku i ka kërkuar Clark-ut që të vazhdojë të ndihmojë Kosovën për

forcim të mëtutjeshëm të lidhjeve të Kosovës me Perëndimin, sidomos me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara.

Vetë Clark ka thënë se impresionohet secilën herë që viziton Kosovën.

“Shpresoj që do të vazhdoni t’i forconi lidhjet me SHBA-në dhe ta shihni atë si mike të mrekullueshme. Ne jemi krenarë me ju, për përparimin që keni bërë, për shembullin që keni

treguar”.


Bombardimet e NATO-s më 1999, ishin operacioni i dytë i madh luftarak i NATO-s, pas sulmeve të vitit 1995 në Bosnje dhe Hercegovinë.

Megjithatë, ajo ka qenë hera e parë që NATO-ja - në historinë e saj të atëherëshme 50-vjeçare - e ka përdorur forcën ushtarake pa miratimin e shprehur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

NATO-ja i ka ndërprerë sulmet pas 78 ditësh - përkatësisht më 10 qershor, 1999 - apo një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës.

Me këtë marrëveshje, të negociuar ndërmjet NATO-s dhe zyrtarëve ushtarakë jugosllavë, forcat jugosllave janë tërhequr nga Kosova dhe është krijuar forca paqeruajtëse ndërkombëtare, e udhëhequr nga NATO-ja./REL

- ✓ Azil i Ri/ Fresh Claim
- ✓ Leave to Remain
- ✓ Anulim Deportimi
- ✓ Bashkim Familjar
- ✓ Human Rights



Zyrë Avokatie me 15 vite Eksperiencë
No Win No Fee For All Applications*

Për më shumë info kontaktoni **Genin në Shqip: +44 777 85 86 335**

+44 203 9300 553

*subject to terms and conditions



Mund të vini në këmbë nga këto stacione:

Bank, Liverpool Street,
Monument, Aldgate,
London Bridge.
EC3V 4AB City Office

Solicitors Regulated By



Morgan Hill Solicitors
SRA No. 669684

ALASTAIR
KING-SMITH

SFIDA MË E MADHE E SHQIPËRISË

Kënaqësi të jemi së bashku për të festuar ditëlindjen e Madhërisë së tij, Mbretit Karl i tretë! Mirë se erdhët të gjithë në festën për Madhërinë e tij, Mbretin Karl i Tretë! U bënë tre vjet që ndodhem këtu në Shqipëri, kësajsoj dua të ndaj me ju disa reflektime personale dhe disa mendime për të ardhmen.

Ka qenë një privilegj të njihja secilin prej jush. Të gjithë ju po jepni një kontribut të rëndësishëm për Shqipërinë. Unë jam i qartë se ky vend ka një potencial të madh. Dhe pikërisht për këtë, jam i qartë se ky vend do të arrijë gjëra edhe më të mëdha në të ardhmen. Si ambasador britanik, unë vendosa të farkëtoj marrëdhënien më të fortë të mundshme mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë.

Ashtu siç edhe Sekretari i Jashtëm britanik, Lord Cameron tha kur ai vizitoi Shqipërinë muajin e kaluar, ne kemi tashmë një partneritet të gjerë që po lulëzon. Një partneritet për sigurinë. Një partneritet për mbrojtjen. Një partneritet të zhvillimit ekonomik dhe tregtar.

Një partneritet për drejtësinë. Dhe kjo është bërë e mundur si rrjedhojë e miqësisë sonë dhe punës suaj të palodhur. Tani, vende të tjera duan të mësojnë nga Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar. Mënyrën se si krijuam një partneritet dypalësh që po jep kaq shumë rezultate, kaq shpejt.

Vitin e kaluar ju bëra thirrje të bëjmë çfarë është e mundur për t'i bindur të rinjtë të mos shkatërrojnë jetët e tyre, duke udhëtuar në mënyrë të paligjshme në Mbretërinë e Bashkuar. Sot, dua t'ju falënderoj për çfarë kemi arritur së bashku për ta ndryshuar këtë, në mënyrë që këtë vit të festojmë lidhjet pozitive dhe në rritje mes popujve dhe vendeve tanë. Turizmi nga Mbretëria e Bashkuar po dyfishohet – ne mund të arrijmë thujse gjysmë milionë vizitorë britanikë deri në fund të këtij viti. Dhe nuk jam i habitur – ky vend ka peizazhe dhe natyrë kaq të veçantë dhe njerëz kaq të ngrohtë e mikpritës në të gjithë vendin. Më ka pëlqyer më shumë se çdo gjë të udhëtoj dhe vizitoj çdo pjesë të Shqipërisë.

Padyshim këtë muaj, ne kemi shumë lidhje që kanë të bëjnë edhe me sportin. I uroj Shqipërisë sukseset më të mira në turneun e futbollit Evropian. Ju shënuat tashmë historinë e turneut me golin fantastik në 23 sekondat e para të ndeshjes kundër kampiones në fuqi, Italisë dhe një tjetër gol në pesë minutat e fundit në ndeshjen kundër Kroacisë. Do të sugjeroja që të tregojmë vlerësimin tonë për Kombëtaren e Shqipërisë dhe të dëshmojmë mbështetjen tonë për pjesën e mbetur të turneut! Anglia po luan me Danimarkën pikërisht tani, ndaj ne – qofshim me fat – do të festojmë fitoren e tyre sonte! Mes katër



shteteve tanë, Skocia është gjithashtu pjesëmarrëse.

Siç mund ta dalloni nga kilti që mbaj veshur, unë jam gjysmë skocez, ndaj jam veçanërisht i kënaqur për të mirëpritur Gardën Skoceze, si bandën tonë ushtarake britanike, këtë mbrëmje. Të premtën, isha në Kukës dhe javën e ardhshme do të jem në Shkodër, për të parë se si investimet tona në veri kanë krijuar vende pune dhe aftësimin e të rinjve. Duke udhënë atyre një shans për të jetuar, studiuar, punuar dhe për të krijuar familjet e tyre këtu.

Është vërtetë frymëzuese të dëgjosh ëndrrat e tyre për të ardhmen, nëse vetëm ndihmon për t'i bërë ato realitet. Ju lutem vazhdoni të bashkoni forcat me ne për t'i bërë këto iniciativa të suksesshme. Mbretëria e Bashkuar është një partner i angazhuar për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Në arenën ndërkombëtare ne përshëndesim si Shqipëria vazhdon të jetë një prej aleatëve tanë më të fortë në NATO, në mbështetje të Ukrainës dhe në qëndrimin ndaj Rusisë në Kombet e Bashkuara. Ky guxim vlerësohet shumë. Ne do të vazhdojmë mbështetjen për ju, si në aspektin e sigurisë ashtu dhe atë ekonomik.

Ne do t'ju ndihmojmë të nxisni lidhjet rajonale dhe të investoni në hekurudha dhe infrastrukturë, në mënyrë që ju dhe gjithkush, në të gjithë Ballkanin Perëndimor, të mund të udhëtoni lehtësisht, të bëni tregti dhe biznes me njëri-tjetrin. Ne do të mbështesim bashkëpunimin tonë të shkëlqyer për sigurinë kufitare, do të forcojmë mbrojtjen tuaj kibernetike dhe do të kryejmë më shumë operacione të përbashkëta mes forcave tona policore, prokurorëve dhe agjencive të inteligjencës për të garantuar sigurinë e qytetarëve. Por ndërsa gjithashtu ekzistojnë shumë kërcënime të jashtme, sfida më e madhe e Shqipërisë, ndërsa vazhdon në rrugën e saj euro-atlantike, me shumë gjasa vjen së brendshmi.

Në vitet e ardhshëm, Shqipëria do ta përmbushë potencialin e saj të plotë vetëm nëse ju merrni pjesë në një përpjekje të përbashkët për të çrrënjësuar korrupsionin, për të forcuar institucionet tuaja demokratike dhe për t'i nxjerrë kriminelet para ligjit. Të gjithë parlamentarëve, zyrtarëve, politikanëve dhe partnerëve të tjerë, jam i kënaqur këtë mbrëmje që shoh kaq shumë përfaqësues të gjyqësorit, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile të mbledhur së bashku.

Mbretëria e Bashkuar do të qëndrojë gjithmonë krah jush që promovoni demokracinë, lirinë dhe zbatimin e ligjit. Një prej arritjeve të mia më krenare ishte të shihnim se sa shpejt Dhoma jonë Britanike e Tregtisë është shndërruar në një kontributore dinamike për të ardhmen e Shqipërisë. Jo vetëm duke na ndihmuar të vazhdojmë rritjen e ndjeshme të tregtisë dhe investimeve dypalëshe çdo vit.

Por duke garantuar bursa studimi për të rinjtë në veri për të studiuar në universitetet shqiptare dhe ato britanike, duke lidhur partneritet me ne për të garantuar mundësi punësimi dhe duke ndihmuar vendosjen e standardeve të integritetit në biznes. Dhe fjala ime e fundit falënderuese i shkon të gjithë ekipit tim në ambasadën britanike; pa dedikimin tuaj të pakursyer, asnjë prej këtyre arritjeve nuk do të ishte e mundur.

Ka qenë një privilegj t'i kaloja këto tri vitet e fundit këtu, duke punuar me ju dhe duke e parë Shqipërinë të lulëzojë për t'u bërë një prej partnerëve më të mirë të Mbretërisë së Bashkuar në rang ndërkombëtar dhe operacional. Uroj që kjo të vazhdojë sa më gjatë! Do të dëshiroja të përfundoja duke

ngritur një doli për Madhërinë e tij, Mbretin. Ditëlindja e tij zyrtare është frymëzimi i kësaj feste dhe të gjitha atyre festave të ngjashme që po zhvillohen në mbarë botën. Javën e kaluar, Madhëria e tij ishte sërisht në Paradën e Rojeve Kalorsiake në Londër, së bashku me Familjen Mbretërore, duke u përshëndetur nga ushtria britanike në paradën ushtarake, që njihet si 'Trooping of the Colour', ashtu si monarkët britanik kanë bërë çdo vit prej vitit 1748.

Ndërsa do të festojmë nën tingujt e bandës së ushtrisë britanike dhe gajdexhiut të mrekullueshëm skocez. Siç do të kërcejmë nën tingujt frymëzues të Juliana Pashës, e cila do të këndojë për ne sot ashtu si në Eurovizion, në vitin 2010.

Ndërsa ne kremtojmë lidhjet e mrekullueshme mes dy vendeve. Ju uroj një mbrëmje të paharrueshme. Faleminderit që jeni me ne! Faleminderit të gjithëve për miqësinë tuaj të ngrohtë, gjatë gjithë mandatit tim në Shqipëri! Dhe ju ftoj të ngrini një doli për Madhërinë e tij, Mbretin Karl i III-të. Për Madhërinë e tij, Mbretin!

* Fjala e ambasadorit britanike gjatë festës për ditëlindjen e Mbretit Charles III

LUTFI DERVISHI

Ndërkohë që debatohet dhe plas sherri edhe për një çadër plazhi vendi është më i bashkuar se kurrë në sportin e preferuar: dhenien e mendve nga karrikja, me moton: “e lehtë si puna e tjetrit”...

Lojtarët e Kombëtaren humbën përballë kampionëve të Europës, por kombi po fiton ekspertize të vyer në fenë e vërtetë të tij, futbollin.


Në vijën e parë janë rreshtuar këngëtarët, njerëzit e botës së spektaklit.

“Po të kishim dalë në Eurovizion me këtë performance do të na kryqezonin në Rinas”, tha një këngëtare e njohur. “Silvinjos nuk iu dëgjua zëri në fushë. Po të pinte ujë të ngrohtë para ndeshjes dhe të hante çokollate të zezë, kordat e zerit do t’i kishte më të lira dhe do të kishte më shumë energji për shkak të rritjes së nivelit të sheqerit. Për mua nuk e kaloi klasën”.

Ndërkohë, influencerët e Instagram-it dhe TikTok thanë se humbja erdhi për shkak se ekipi nuk ishte fokusuar sa duhet me prezencën në rrjetet sociale për t’i “kompleksuar” kundërshtarët.

Gjyqtarët dhe prokurorët, (që kanë kaluar Vettingun), dhane verdiktin e tyre për mbrojtësin e djathtë Hysaj:

“Ulja e kokës pas gjuajtje së sulmue-



sit italian Barrela, ndonëse në dukje veprim instiktiv në të vërtetë ishte krim i konsumuar në sytë e 50 mijë dëshmitareve. Neni 282 i kodit penal, shpërdorimi detyrës”.

Një avokat i njohur si mbështetës i opozitës kërkoi që SPAK të hapë urgjentisht hetimet për konspiracion.

“Kam parë një foto të kryeministrit me mbrojtësin Hysaj, mesfushorin Ramadani dhe sulmuesin Broja. Kemi të bëjmë me korruptim të të gjithë sektorëve të fushës. Dihet që Edi Rama para interesave të Melonit dhe Italisë nuk vë as veten. Ndashja nuk është shitur, por dhuruar. Ky është Gjadri nr. 2”.

Korit të kritikave iu bashkuar edhe pedagogët:

“Mesfusha ishte po aq e dobët sa dhe rezultatet e Pizës në arsim”, shkroi njëri prej tyre me titullin Dr., duke sugjeruar masa të rrepta disiplinore “vetëm për lojtarët që bënë pasime të gabuara”.

HUMBËM NDESHJEN, POR FITUAM EKSPERTË

Një analist politik tha se “Strategjia e ekipit ishte po aq e dobët sa lufta ndaj korrupsionit. Fjalët që degjuam ishin shumë të bukura, por ajo që pamë ishte katastrofë”.

Një analist tjetër mbështetës legjendar i reformave 12 vjeçare të qeverisë, kritikoi lojtarin më të mirë, Brojën.

“Qasja e tij ndaj Italisë duhej të ishte po aq e sofistikuar sa ajo që përdor Rama në diplomaci. Kryeministri edhe pse i vetëm shkelqen para gjithë të medhenjve. Broja nuk u ngrit dot në lartësinë e Rames. Kaq e thjeshtë është”.

Për ndeshjen dhanë mendime edhe disa trainerë e ish-futbollisteve të njohur, por ata u injoruan pasi u vlerësuan se janë në konflikt interesi me çështjen.

Njeriu më i shqetësuar nga dallga e komenteve dhe cunami i analizave është Pirro Misha.

“Uroj të mos më kërkojnë që të arshivoj këshillat për Kombëtaren sepse mund të mbushet me material dy herë Biblioteka Kombëtare”.

Complete
glasses from
just £15

Includes standard
single-vision lenses only



That's what you call face value

Ask in store for details or go to [specsavers.co.uk](https://www.specsavers.co.uk)

You're better off with

Specsavers

EURO 2024: MURINJO, BBC DHE THE GUARDIAN FLASIN ME SUPERLATIVA PËR SHQIPËRINË

Trajneri i Fenerbahces, Jose Mourinho e lavdëroi lojën e Shqipërisë në Euro 2024, duke thënë se skuadra jonë kombëtare theu çdo parashikim këtë Europian, edhe pse ishte në atë që e përshkroi si “grupin e vdekjes”, me Italinë, Spanjën dhe Kroacinë.

Performanca e Shqipërisë në dy ndeshjet e para, me Italinë dhe Kroacinë, nuk është parë që nga Kosta Rika 2014.

“Shqipëria është një nga skuadrat që theu çdo parashikim. Në grupin e vdekjes, pritshmëri zero, stadiume plot, lojë të mirë, trajner i rastësishëm brazilian, gola në 20 sekonda, gola në minutën e fundit, dhe ende gjallë.

Nuk e kemi parë këtë që nga Kosta Rika 2014. Kulmi i futbollit”, ishte mesazhi i tranjerit legjendar, i parë në histori që arriti të çojë tre skuadra të

ndryshme në gjysmë-finale të UEFA Champions League. Shqipëria, nga Hirushja’ e Euro 2024, siç e cilësonte Calciomercato në Itali, ka tërhequr vëmendjen e komentatorëve të ndryshëm sportivë të cilët mendojnë se tashmë kuqezinjët po lënë shenjë e tyre në këtë grup “ferri”.

Për një lojë tejet të bukur nga ana e kombëtares sonë flet edhe gjigant britanik BBC, i cili e përshkruan golin e barazimit në ndeshjen me Kroacinë si një bllokues dramatik që i mohoi fitoren kroatëve dhe i dëmtoi rëndë shpresat e finalistëve të Kupës së Botës 2018 për të mbërritur në fazën eliminatore të Euro 2024.

Gjasula tha fjalën e fundit, vazhdon



shkrimi, çka nënkupton se Kroacisë tani do t’i duhet të mundë kampionët

në fuqi, Italinë në ndeshjen e fundit të Grupit B për të pasur një shans

avancimi. Sa për përballjen e kombëtares shqiptare me Spanjën, BBC e përshkruan vërtet si një sprovë të vështirë, ama thekson se se paraqitja e vendit tonë në këtë kampionat do të mbetet gjatë në kujtesën e tifozëve.

Një tjetër media prestigjiozë, The Guardian flet deri për “një ringjallje lindore “ në Euro 2024 dhe për një testament të ecjes përpara pavarësisht probleme me të cilat janë ndeshur, siç thuhet në artikull, këto 30 vitet e fundit. Ekipi duket i frymëzuar, shkruan The Guardian nga trajneri i tij, ish-mbrojtësi i Arsenalit, Sylvinho, i cili promovoi një sërë lojtarësh të rinj dhe drejtoi një seri të tërë ndeshesh të pamposhtura për të përfunduar në krye të grupit kualifikues.

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

The collage displays a variety of business cards for different construction and renovation companies. Each card includes a QR code for easy contact, the company name, and key services offered. The companies shown include:

- FD CONSTRUCTION**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works.
- LEO'S BAR & GRILL**: Authentic Mediterranean Cuisine.
- K ROOFING LTD**: New Roof-Lead Work-Flat Roof.
- E&G STEELFIXING**: Steel Fixing, Fabrication, Welding, Ground Beams.
- TUSHA CONSTRUCTION**: The Best of Construction. Services: Loft Conversion, Extension, Refurbishment, General Building Work.
- B&B LONDON CONSTRUCTION LTD**: Our Services: Kitchen and Bathroom, Paving & Landscaping.
- A&D CONSTRUCTION LTD**: 7 St Pauls Mews, Crawley RH10 1DR.
- JD CONTRACTORS**: We have more than 10 years of experience in the building industry.
- A&O SCAFFOLDING LTD**: Contact Us: Mob: 07552585665, Mat: 07533964532.
- OUR SERVICES**: CIVIL ENGINEERING & GROUNDWORKS, PAVING & LANDSCAPING, DRAINAGE, DRIVEWAYS & PATIOS, DEMOLITION.
- OUR SERVICES**: LOFT CONVERSION, EXTENSION, FULL REFURBISHMENT, PLUMBING & HEATING.
- OUR SERVICES**: Temporary Roof Systems, Gentry's and Loading Bays, Painters scaffolds, Access Towers, Chimney Stacks, Pavement Scaffolds, Birdcages, Internal High Status Scaffolds, Bricklayers Scaffolds.
- SERVICES: LALA SCAFFOLDING**: Temporary Roofs, Domestic Scaffolding, Industrial Access, Competitive Rates, Professional and experienced Scaffolders, Personalised services, all scaffolding work undertaken.
- BKB LANDSCAPE LTD**: 42 Devenay Rd, London, E15 4AY.
- ART CONSTRUCTION GROUP**: DISCOVER THE QUALITY. MANAGER: M. MOXHEJRI: 07476768895, DIRECTOR: P. OMERI: 07521731006.
- Construction Services**: info@erkconstruction.co.uk, Web: www.erkconstruction.co.uk.
- MR BUILDING SOLUTIONS**: YOU DREAM IT, WE BUILD IT. +44 7828 079936, www.mrbuildingsolutions.co.uk.
- Services**: LANDSCAPING, PAVING, DECKING, FENCING, BRICKS, SLABS, ARTIFICIAL TURF ETC.
- LALA SCAFFOLDING LTD**: Southend Armental Road Harchurch, Essex, CO17 1ZS374, 07506 864 035, info@lalascaffolding.co.uk, www.lalascaffolding.co.uk.
- OUR SERVICES**: REPAIRMENT, EXTENSIONS & LOFT CONVERSIONS, GARDENS & FOUNDATIONS, BENCH WORK, TILING, PAINTING & DECORATING, CARPENTRY, ELECTRICAL & PLUMBING, PAVING & LANDSCAPING, ROOFING, BRICKLAYING, STEELFIXING.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ

BASHKIM SHALA

BIRN

Dy dekada pas nisjes së punimeve, ura e madhe e rrugës së Kombit është drejt përfundimit, por përfaqësuesit e biznesit dhe shoqërisë civile ankohen se ky investim do ta izolojë edhe më tej bashkinë e Kukësit dhe fshatrat përreth.

Punimet për ndërtimin e urës së re mbi lumin Drini i Zi në Kukës kanë hyrë në fazën përfundimtare dhe në fund të qershorit është planifikuar të lëshohet për qarkullim. Por ekspertët thonë se kjo vepër e madhe infrastrukturore e Rrugës Kombit, e dyta pas tunelit të Kalimashit, do të izolojë më tej Kukësin, Tropojën, Hasin dhe rrethinat e tyre.

Projekti mbyll hyrjet dhe daljet aktuale për në Kukës, ndërsa fshatra të njëjve administrative të Mamëzit, Surroit, Arrënit e Malziut do duhet të udhëtojnë 8 kilometra vajtje- ardhje shtesë për shkak të saj.

“Ura e re është një imazh që nuk i përket Kukësit. Kjo urë nuk lidh harmonikisht, ekonomikisht, apo fizikisht qytetin e Kukësit. Vepra është një “brryl” që i bëhet Kukësit,” thotë Andrit Shehu, arkitekt dhe ish-drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Bashkinë e Kukës.

Ndërtimi i kësaj ure, sipas projektit, do të nxjerrë jashtë loje urën ekzistuese duke bllokuar njëherësh edhe hyrje-daljet historike në qytetin e Kukësit. Hyrje-daljet janë planifikuar të bëhen përmes Bypass-it të Gostilit, në një rrugë rreth katër kilometra më të gjatë dhe që sipas inxhinierit, nuk është aspak të përshtatshme për të përballuar fluksin e qarkullimit.

Edhe komuniteti i biznesit e përfaqësuesit e shoqërisë civile e shohin zgjatjen e rrugës për në qytetin e Kukësit si “politikë izolimi”.

Ndërkohë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, ARRSH, i lau duart nga problemi, duke thënë se “ky segment është pjesë e kontratës koncesionare”.

URA E MADHE MBI LUMIN DRIN RREZIKON TA KTHEJË KUKËSIN NË “ISHULL TË HARRUAR”



Por kompania koncesionare, Albanian Highway Concessions pretendoi se nuk kishte asnjë detyrim kontraktual për hyrje-daljet për bizneset dhe banorët në Kukës.

“I vetmi detyrim i yni do të jetë rampa në pjesën veriore të urës (kur vjen nga Kosova),” tha për “BIRN” Spartak Tumani, drejtor i Albanian Highway Concessions.

Ura e vështirëson komunikimin

Ura e Madhe mbi lumin Drin është projektuar nga inxhinieri italian Giorgio Rizzo. Ajo ka një gjatësi totale prej 310 metra, ndërsa harku metalik ka një bazë prej 270 metrash, një lartësi prej 56 metrash dhe peshon rreth 5000 ton. Do të ketë 4 korsi, në dy kahet e lëvizjes me ndarës trafiku të ndërmjetëm dhe me kavo çeliku që fiksohen nga bazamenti në harkun e urës.

Në mars, kryeministri Edi Rama publikoi me mburrje në rrjetet sociale pamje nga punimet e fundit për ndërtimin e urës së re të Kukësit, duke këmbëngulur ndër të tjera se investimi ishte një ngjarje e madhe ekonomike për zonën.

“Investimi prej 30 milionë dollarësh e bën atë një ngjarje ekonomike për

zonën dhe lidhjen e Shqipërisë me Kosovën,” shkroi Rama.

Por për banorët e qytetit të Kukësit, ura e re jo vetëm që nuk i shërben qytetit dhe rrethinave, por kthehet në një pengesë shtesë për lëvizjen e tyre dhe e kthen qytetin në një ishull të harruar.

“Nuk do ndalojë më njeri në Kukës, madje as kuksianët e larguar, të cilët gjatë udhëtimit për në Kosovë, ndaloheshin në Kukës. Qytetarët e Kukësit nuk kanë asnjë benefit. Do u ndalohet hyrja historike që nga viti 1978,” thotë Andrit Shehu.

Drejtuuesi i Qendrës për Progres Rinor, Rifat Demalija, kërkon reagimin e qytetarëve dhe të pushtetit lokal, pasi sipas tij ky projekt do të sjellë pamundësimin e jetesës në këtë qytet.

“Sipas projektit që po përfundon së shpejti, rezulton se nyja hyrëse e dalëse e qytetit të Kukësit për nga ura aktuale e Drinit të Zi ka ndryshuar. Pra, hyrja historike e Kukësit zhvendoset rreth katër kilometër më larg për në fshatin Gostil,” thotë për “BIRN” Demalija.

Ai shtoi se përfaqësuesit e shoqërisë civile kishin zhvilluar një takim me këshillin bashkiak mbi këtë problem tre vjet më parë dhe e kanë kundërshtuar

projektin. Demalija shtoi se ky devijim shtonte problemet e trafikut, rrezikon nga aksidentet dhe se në fakt qyteti veçohej.

“Kukësi do anashkalohet nga vizitorët dhe turistët,” tha ai.

Për biznesin lokal, zgjatja me 4 kilometra dhe spostimi i hyrjes për në qytet është një problem shtesë pas tarifave që ata paguajnë për t’u lidhur me Durrësin dhe Tiranën.

“Nëse trau i pagesës na vështirëson jetën në Kukës, ky na detyron të gjejmë një rrugë dhe të largohemi nga qyteti,” thotë Sokol Kolgjini nga shoqata “Biznesi për Biznesin”.

Kolgjini ironizon projektuesit e rrugës dhe mënyrën se si ajo lidhet me qytetin. “Çdolloj infrastrukture duhet të lehtësojë komunikimin, por ky projekt e vështirëson atë. Do të jetë një kaos në trafik, sepse i gjithë trafiku për Has dhe Tropojë duhet të kalojë përmes qytetit, në një rrugë plot trafik si rruga e pazarit”, thotë për “BIRN” Kolgjini.

Autoritetet pa zgjidhje

Rruga hyrëse dhe dalëse nga ana juglindore e Kukësit është ndërtuar para viteve ‘90 të shekullit kaluar. Rruga u shërbente atëherë banorëve të disa fshatrave dhe kishte një trafik të kufizuar. Inxhinieri Andrit Shehu thotë për “BIRN” se ajo nuk është e përshtatshme për të përballuar qarkullimin dhe hyrje-daljet e të gjithë zonës.

Shehu thotë se gjatë kohës që punoi në bashki, ai mbajti dhjetra korrespondenca, përfshi me kryeministrin Rama për të kërkuar një projekt që do i shërbente edhe qytetit të Kukësit, por nuk mori përgjigje.

“Deri në momentin që unë jam larguar nga bashkia (6 muaj më parë) nuk ka pasë asnjë lloj dashamirësie nga instancat shtetërore për të dërguar një grup profesionistësh për të diskutuar për alternativat,” thotë ai.

Shehu thotë se zgjidhjet teknike për të ruajtur të pacënuar hyrjen e vjetër të qytetit kanë qenë të mundura, por propozimet nuk janë marrë parasysh.

“Janë 75 mijë banorë të qarkut të Kukësit që tashmë u duhet të aksesojnë qytetin përmes një hyrje aspak dinjitoze. Ndërkohë që koncesionari ka bërë bypass në zonën e Mirditës, edhe për fshatra me 10 shtëpi,” thotë ai.

Bashkia e Kukësit i tha BIRN se prej disa vjetësh ka kërkuar të njihet me projektin dhe zgjidhjen që u ofrohej banorëve të Kukësit. Bashkia vetë propozon një projekt shtesë prej gati 300 milion lekësh, për rikonstrukcionin e rrugës hyrëse Ura e Drinit të Zi-Radio – Kukësi.

Në korrespondencë me bashkinë, Ministria e Infrastrukturës përgjigjet se hyrja për në qytet ishte marrë në konsideratë nga ana e shoqërisë koncesionare.

“Nga ana e shoqërisë koncesionare, në projektin e propozuar për ndërtimin e Urës së Re mbi lumin Drin, është marrë në konsideratë lehtësimi i hyrje-daljeve në qytetin e Kukësit, duke shfrytëzuar urën dhe rrugën ekzistuese”, thuhet në një përgjigje që bashkia ka marrë dhe që iu vu në dispozicion BIRN.

Por në një komunikim me BIRN, drejtuesit e kompanisë AHC-së thonë se ky nuk është një problem i tyre.

“Pjesa tjetër është problem social që duhet të gjejë zgjidhje nga qeveria dhe autoritetet vendore. Më konkretisht kërkohet një projekt i ri,” tha për “BIRN” Spartak Tumani, drejtor i Albanian Highway Concessions.

(Reporter.al)



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

REL

“EURO 2024”, ARENË E RIVALITETEVE BALLKANIKE

Teksa ekipet kombëtare të vendeve nga Ballkani që po garojnë në Kampionatin Evropian të futbollit në Gjermani nuk përballëshin mes vete në fushën e gjelbër, tifozët e tyre ishin në qendër të vëmendjes në javën e parë të turneut, duke shkaktuar incidente të ndryshme, që u ndëshkuan nga Federata Evropiane e Futbollit.

Ditët e para të Euro 2024, që nisi më 14 qershor, u shënuan me disa incidente, në të cilat u përfshinë kryesisht tifozët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, të Shqipërisë dhe të Serbisë në veçanti, por edhe një futbollist dhe një gazetar i sportit.

Por, shumica e incidenteve u përqunduan rreth Kosovës, pavarësisht e së cilës Serbia nuk e njeh.

Çfarë ndodhi dhe kush u përfshi?

UEFA ka gjobitur Shqipërinë dhe Serbinë për incidentet e shkaktuara nga tifozët e tyre, dhe është duke hetuar Shqipërinë dhe sulmuesin e saj, Mirlind Dakun, për incidente të tjera.

Federata Shqiptare e Futbollit u dënua me gjobë prej 37.375 eurosh nga UEFA, për shkak të sjelljeve të tifozëve të saj në humbjen 2:1 kundër Italisë, në ndeshjen hapëse të Grupit B, më 15 qershor, në Dortmund.

Në një njoftim, më 19 qershor, UEFA tha se, ndër të tjera, dënoi FSHF-në me 10.000 euro për shkak të “përçimit të mesazheve provokuese, të papërshtatshme për një ngjarje sportive”.

Tifozët e Shqipërisë e shpaleshin një baner me flamurin e vendit të tyre që zgjeron kufijtë brenda territorit të vendeve fqinje, gjatë asaj ndeshje dhe gjatë ndeshjes kundër Kroacisë, më 19 qershor. U raportua se ata shpaleshin edhe një flamur me stemën e



ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Serbia, në anën tjetër, u gjobit me 10.000 euro, pasi Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i UEFA-s gjeti se tifozët e saj “përquan mesazhe provokuese, të papërshtatshme për një ngjarje sportive”, si dhe me 4.500 euro për hedhjen e sendeve në fushë, në humbjen 1:0 kundër Anglisë, më 16 qershor, në Gelsenkirshen. Para asaj ndeshjeje, shtatë tifozë serbë u arrestuan për shkak të një përlëshjeje me tifozët anglezë, në qytetin perëndimor gjerman. Federata e Futbollit e Kosovës bëri ankesë në UEFA për, siç ka thënë, shfaqjen e flamujve, sloganëve dhe thirrjeve të tifozëve serbë me “mesazhe politike, shoviniste dhe raciste kundër Kosovës”, gjatë ndeshjes Serbi-Angli. Fotografitë nga turma e tifozëve serbë gjatë ndeshjes shfaqën një baner të flamurit kombëtar serb dhe të një harte, e cila përfshinte Kosovën brenda kufijve të Serbisë. Një grup i tifozëve serbë bro-

horitën “Kosova është zemra e Serbisë” në qendër të Munihut, ku ishin mbledhur para ndeshjes së ekipit të tyre kombëtar kundër Sllovenisë, më 20 qershor.

Federata serbe është gjobitur edhe në të kaluarën për shkak të Kosovës, edhe nga organi qeverisës i futbollit botëror, FIFA, pasi lojtarët serbë e kishin shfaqur në Kupën e Botës 2022 një flamur me një hartë, ku Kosova ishte paraqitur si pjesë e Serbisë. Ky flamur u pa në dhomat e zhveshjeve së përfaqësueses serbe gjatë ndeshjes midis Brazilit dhe Serbisë, të zhvilluar më 24 nëntor 2022, në Katar.

Më 19 maj, UEFA i hoqi akreditimin një gazetari kosovar për ndeshjet e Euro 2024, pas ankesave se ai bëri gjeste nacionaliste drejtuar tifozëve serbë, gjatë ndeshjes së Serbisë kundër Anglisë. Federata serbe u ankuar se gazetari Arlind Sadiku i provokoi tifozët serbë kur u kthye nga ta gjatë një transmetimi të drejtpërdrejtë,

dhe bëri shqiponjën dykrenore me duart e tij. Ky gjest është imitim i shqiponjës në flamurin kombëtar shqiptar. Sadiku e pranoi se gjesti i tij ishte joprofesional për një gazetar, por argumentoi se nuk ishte “fyes ndaj askujt”.

Për çfarë tjetër po hetohet Shqipëria dhe futbollisti i saj kosovar, Daku?

UEFA njoftoi më 20 qershor se Komisioni i saj Disiplinor dhe i Etikës ka emëruar një inspektor për të kryer një hetim në lidhje me thirrjet e mundshme “raciste dhe, apo diskriminuese nga tifozët” gjatë barazimit mes Shqipërisë dhe Kroacisë, në Hamburg, një ditë më herët.

Tifozët e Kroacisë dhe ata të Shqipërisë dyshohen se brohoritën “vrisni, vrisni, vrisni serbët” gjatë ndeshjes mes kombëtareve të tyre në Hamburg, ndërsa Serbia kërcënoi se do të tërhiqet nga Euro 2024, nëse UEFA nuk i dënon federatën kroate

dhe atë shqiptare.

UEFA nisi një hetim të ndarë, më 20 qershor, kundër sulmuesit të Shqipërisë, Mirlind Daku, për “sjellje të pahijshme” pas barazimit të kuqezinjve kundër Kroacisë, në Hamburg. Daku, i lindur dhe i rritur në Kosovë, e përfaqësoi atdheun para se të vendoste t’i bashkohej Shqipërisë më 2023. Ai u kap në kamerë duke i nxitur tifozët me thirrje përçmuese për Maqedoninë e Veriut, pas barazimit të Shqipërisë 2:2 me Kroacinë. Federata e Futbollit e Maqedonisë së Veriut dënoi sjelljen e Dakut, duke e cilësuar si “të papranueshme dhe skandalozë”.

Në një postim në Facebook, një ditë më vonë, Daku kërkoi falje për sjelljen e tij. “Falja është burrërore, dhe e ndiej obligim moral dhe profesional ta bëj një gjë të tillë, për gjithë ata që janë lënduar”, shkroi Daku.

UEFA pritet të vendosë për Shqipërinë dhe Dakun, por nuk dihet nëse do ta bëjë këtë para ndeshjes së fundit të Shqipërisë në Grupin B, të hënën, kundër Spanjës. Daku rrezikon pezullimin, ndërsa kombëtarja kuqezi gjobë tjetër.

Kush tjetër u dënua?

Incidenti i vetëm në të cilin nuk u përfshi një ekip nga Ballkani ishte ai i ndeshjes hapëse mes organizatores së turneut, Gjermanisë, dhe Skocisë më 14 qershor.

UEFA e dënoi Federatën e Futbollit të Skocisë me gjobë prej 5.625 eurosh, pasi tifozët e saj hodhën gjësende në fushë gjatë ndeshjes në Munih.

Ndërkaq, futbollii skocez, Ryan Porteous, u pezullua me dy ndeshje, pasi ishte përjashtuar me karton të kuq për një ndërhyrje të rrezikshme gjatë ndeshjes.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

E nesërmja fillon tani!

Dotech
websites 

Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona

Dotech
websites 


Na kontaktoni:
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



**FOR
SALE**

**Barbershop for sale near
Old Street station London N 1**



Barbershop For Sale

Good selling price

**Long establish business
since 1967 reason for
selling Owner retiring**

Contact Us

07305 74 0907

**Cheap rent
Easy renewable lease**



REASONABLE PRICE



REASONABLE PRICE



07913 693801

Contact John evening after 7 30 pm

MUNGESA E CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË, PENGESË PËR ZHVILLIMIN NË VERI TË VENDIT

Në Shqipëri, megjithëse kanë kaluar më shumë se 30 vite nga rrëzimi i sistemit komunist, i cili nuk njihje pronën privat, pjesa më e madhe e banorëve që jetojnë në zonat malore, në veri të vendit, vazhdojnë të mos pajisen me çertifikatën e pronësisë për banesat dhe tokat e tyre.

Ndërsa në vitin 1991, kur ndryshoi sistemi politik në Shqipëri dhe kur të gjithë krahët e politikës miratuan ligjin 7501 për ndarjen e tokës, banorët e zonave malore në Veri të Shqipërisë e refuzuan atë dhe u kthyen në tokat dhe trojet e trashëguara nga të parët.

Por, kur drejt Thethit, Valbonës, Vermoshit, Lëpushës, Tamarës, apo Razmës u shfaqën turistët, të shtyrë nga peisazhet alpine, tradita e mikpritjes, veshjet apo ushqimi, pjesa më e madhe prej tyre u përballën me mungesën e çertifikatave të pronësisë dhe pamundësinë për zhvillimin e pronës.

Kryetari i shoqatës “Dukagjini”, Ndue Sanaj, i tha Zërit të Amerikës se këtë shqetësim ua kanë paraqitur autoriteteve para 20 vitesh, por deri tani nuk është bërë asgjë.

“Ne e kemi filluar problematikën e kësaj çështje që në vitin 2008. Fakti është se e gjithë zona e Dukagjinit, ashtu siç kam njohuri unë edhe malet e tjera nuk kanë tapi (certifikatën e pronësisë) për pronat”, thotë ai.

Drejtuuesi i shoqatës “Dukagjini” thotë se, përveç zonave të njohura për turizmin malor, edhe në zonat e tjera malore mungesa e çertifikatave të pronësisë po pengon zhvillimin.

“Janë të regjistruara që në vitin 1947,



por tapi (certifikatën e pronësisë) nuk ka askush. Thethi ka probleme sepse është vendi që vijojnë turistët, dhe jo pak, por në vendet e tjera në malësi akoma nuk kanë dalur këto probleme, sepse akoma nuk është zhilluar turizmi”, thotë ai.

Nevoja për të investuar në ndërtimin e bujtinave apo rikonstruktimin e kullave ekzistuese i ka përballur banorët me ligjin. Dhjetëra banorë janë ndaluar nga policia dhe proceduar nga prokuroria për ndërtime të jashtëligjshme.

Sipas avokatit Anton Kosteri mungesa e titujve të pronësisë vazhdon t'i penalizojë banorët e zonave malore, përfshirë edhe ata të zonave turistike.

“Në këto zona do të jetë shumë e vështirë për të bërë investime sepse

çdo ndërtim, qoftë edhe një tullë që do të vendoset atje, do të konsiderohet se vendoset në një tokë shtet dhe jo në tokën e tyre të trashëguar prej qindra vitesh, kjo për shkak të mos regjistrimit të titujve të pronësisë”, thotë ai.

Por avokati Kosteri thotë se, nëse politika dhe qeveria janë të gatshme për të mbështetur zhvillimin e këtyre zonave të varfëra, atëherë mund të gjenden zgjidhje për paisjen e tyre me çertifikata të pronësisë.

“Në këto kushte unë e çmoj të domosdoshme ndërhyrjen e shtetit duke ngritur grupe pune pranë njësive vendore, duke thirrur edhe persona, banorët më të vjetër, për të përcaktuar së pari kufizimet dhe të drejtën e pronësisë së gjithsecilit, sepse secili banor atje e di se ku e ka pronën e tij. Dhe mendoj që, me ngritjen e këtyre komisioneve me kryetarët e fshatrave, me përfaqësuesit e njësive administrative dhe me ekspertë të fushës, jam i sigurtë se gjendet zgjidhja, por nëse ekziston vullneti politik”.

Muajin e kaluar, Kryeministri Rama, gjatë një vizite në qendrën turistike të Thethit, u premtoi banorëve fshirjen e të gjitha gjobave për ndërtimet e paligjshme të bërë ndër vite në mungesë të çertifikatave të pronësisë si dhe zgjidhjen e problemeve të pronësisë duke i pajisur me titujt e pronësisë për pronat e trashëguara. /VOA



**NA GJENI NA FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dottech
website



Shifrat e institucioneve në Shqipëri tregojnë rritje të numrit të turistëve në këtë vend.

Të fundit, të publikuara nga Instituti i Statistikave – Instat, janë për tremujorin e parë të vitit 2024 dhe flasin për 1 milion e 700 mijë turistë, ose 59% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pushues dhe ekspertë të turizmit e ekonomisë thonë se turizmi në vend është shtrenjtuar dhe arsyet, sipas tyre, janë nga më të ndryshmet.

Më shtrenjtë njësitë akomoduese, por edhe ushqimet

Mehdi Olluri, nga Lipjani i Kosovës, zgjodhi që edhe sivjet pushimet t'i bëjë në Shëngjin – pjesa veriperëndimore e Shqipërisë.

Ai thotë se krahasuar me një vit më parë, çmimet janë më të larta.

“Ka rritje të [çmimeve të] ushqimeve në dyqane, në restorante, e gjithashtu edhe banesa është më e shtrenjtë se vjet”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Të dhënat e operatorëve turistikë tregojnë se të gjitha produktet turistike janë shtrenjtuar. Kështu, një çadër me dy shezlonë nuk gjenden më me afërsisht 5 euro, por mbi 7 euro, e në disa zona në jug të Shqipërisë arrijnë deri në 50 euro.

Edhe apartamentet që vjet mund të gjendeshin edhe me 25 euro, sivjet variojnë nga 30 deri në 100 euro për një natë, ndërsa dhomat në hotele nga 100 deri në 500 euro.

Çmimet, sigurisht, ndryshojnë nga zona dhe periudha – në korrik dhe në gusht janë më të shtrenjta.

Mirilda Tili, gazetare e ekonomisë në Shqipëri, thotë se turizmi sivjet është më i shtrenjtë se një vit më parë, apo në krejt 5-vjeçarin e fundit.

Arsyet, thotë ajo, lidhen me investimet në turizëm dhe tregun e punës.

“Është fakt që në vitin 2024 ka struktura të shtuara akomoduese, sepse edhe lejet e ndërimit kanë qenë për 30-40 për qind më shumë se një vit më parë. Janë shtuar hotelet që tentojnë të sjellin brende, sepse janë të përjashtuara nga taksat dhe TVSH-në e kanë 5 për qind”.

“Kjo do të thotë se ka kërkesa për staf të shtuar, por se burimet janë të pakta, ka mungesë punëtorësh. Kështu që, ata pak punëtorë që gjenden, do të paguhen me paga të larta dhe, de-tyrimisht, kjo është kosto që faturohet te turisti”, thotë Tili për Radion Evropa e Lirë.

Si një problem të madh, ajo përmend edhe zhvlerësimin e euros.

“Rënia e euros ka sjellë rritje të çdo produkti turistik. Një vit më parë, eu-

SHQIPËRIA MIRËPRET MË SHUMË TURISTË, POR ME ÇMIME MË TË LARTA



roja këmbehej me 109 lekë, ndërsa aktualisht këmbehet me 100 lekë ose më pak”, thotë gazetarja e ekonomisë.

Mbiçmimin e lekut e sheh si arsye kryesore të rritjes së çmimeve në turizëm edhe ekspertja e turizmit, Flora Xhemani Baba.

“Paketat turistike janë rritur për 10-15%. Arsyeja kryesore është luhata e madhe e euros”, sipas saj.

“Ekspertët e ekonomisë kanë vlerësuar se kjo nuk ndodh për shkak të sezonit turistik dhe kërkesës së lartë, por për arsye të brendshme të qarkullimit joformal të parasë në ekonomi”, thotë Xhemani Baba.

Sipas saj, një prej arsyeve që ka rritur numrin e turistëve në Shqipëri është edhe shtimi i fluturimeve ‘low cost’, apo me çmime më të volitshme, ashtu si edhe i fluturimeve direkte nga disa qytete të Evropës.

“Tjetër arsye e rëndësishme është edhe marketingu ndërkombëtar që i është bërë Shqipërisë si nga burime zyrtare, nga vetë kryeministri dhe agjenci të turizmit, por edhe nga ata që njihen si influencers të opinionit”, thotë Xhemani Baba.

Ajo shton se rritja e numrit të tur-

istëve është një trend në të gjithë botën dhe, në këtë aspekt, turizmi në Ballkan është ndër më të kërkuarit.

“Rreth 750 milionë njerëz në botë udhëtojnë çdo vit në vendet e Mesdheut dhe Shqipëria është pjesë e kësaj pakete”, thotë Xhemani Baba.

Ajo, po ashtu, vë re se ka shtim të turistëve individualë, që, siç thotë, udhëtojnë për aventura të ndryshme, e jo për turizëm plazhi, dielli a rëre.

“... sepse, aktualisht, në plazhe është njësoj si çdo vit tjetër. Jemi në fund të qershorit dhe plazhet gjatë javës janë thuajse boshe, por qytetet turistike janë plot – Tirana, Durrësi, Berati, Kruja, Shkodra, Gjirokastra, Saranda, apo edhe qytetet e vogla si: Gramshi, Belshi, Puka, Dibra, Përmeti, që ofrojnë turizëm të aventurës dhe trashëgimisë kulturore”, thotë Xhemani Baba.

Më shumë turistë, por shpenzojnë më pak

Ajo dhe ekspertë të tjerë ngrenë shqetësimin, po ashtu, për mosdeklarimin e të ardhurave nga turizmi. Sipas saj, autoritetet e vendit nuk duhet të përqendrohen te numrat, por te të ardhurat.

“Nëse kemi të ardhura prej 4.2 milionë eurosh në vitin 2023 me 10 milionë turistë... i bie që një turist vjen për 4-5 ditë dhe shpenzon rreth 350 euro... Ose diçka nuk shkon me shifrat e turistëve, ose evazioni është shumë i lartë”, thotë ajo.

Sipas Fjerolt Ozunit, ekspert dhe operator turistik në Shqipëri, sektori i turizmit nuk është ende i qëndrueshëm.

“Ne duhet të mësojmë se si ta bëjmë turistin e huaj të shpenzojë këtu te ne. Duhet të mësojmë t’i shesim paketat në mënyrë të tillë që ata t’i harxhojnë paratë. Ka nga ato grupe që vijnë dhe thonë që nuk kemi se si t’i shpenzojmë... kishim parashikuar të shpenzonim më shumë”, thotë Ozuni për Radion Evropa e Lirë.

Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se të ardhurat nga turizmi në periudhën janar-mars 2024 arritën në 778 milionë euro nga 624 milionë sa ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë, por, sipas tyre, një turist shpenzoi më pak se një vit më parë. Sivjet, një turist i huaj shpenzoi mesatarisht 513 euro, ndërsa në janar-mars të 2023-ës kjo shifër ishte 582 euro.

Më 18 qershor, Administrata Tatimore

e Shqipërisë u bëri thirrje bizneseve që operojnë në fushën e turizmit, ta deklarojnë numrin real të punonjësve si dhe pagat reale të tyre. Në letrën sensibilizuese u tha se do të nisnin kontrole fizike dhe se do të ketë edhe masa ndëshkuese.

Vitin e kaluar, media ndërkombëtare e renditën Shqipërinë si një ndër destinacionet më interesante të atij sezoni veror, qoftë për plazhet, zonat malore, ushqimet apo edhe çmimet e volitshme.

“Turizmi masiv i ka sjellë vendit shumë të ardhura, por duhet të synojmë majat e industrisë turistike botërore”, tha atëkohë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

Për të përballuar fluksin e turistëve gjatë këtij sezoni, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Muhamet Rrumbullaku, firmosi një urdhrë për anulimin e lejeve të pushimit për punonjësit që kanë detyrë sigurinë dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik.

Sipas këtij urdhri, lejet anulohen nga data 20 qershor deri më 15 shtator.

(Radio Evropa e Lirë)

IRENA BEQIRAJ

TRURI KOLEKTIV QË DUHET NDRYSHUAR!

A't Zef Pëllumbi thoshte “populli shqiptar duhet të ndryshojë trurin”!

Në 100 vjet shtetformim ne kemi ndryshuar udhëheqësit por kurrë trurin. Ndërkohë që sekret i suksesit njerëzor nuk qëndron në inteligjencën e lindur individuale, por në trurin tonë kolektiv – në aftësinë e grupeve njerëzore për t'u ndërlidhur shoqërisht dhe për të mësuar nga njëri-tjetri gjatë brezave.

Biologu Joseph Henrich na tregon se aftësia për bashkëpunim ka qenë forca kryesore që ka çuar përpara procesin evolucionar njerëzor. Formimi i trurit kolektiv ka nxitur evolucionin gjenetik të specieve njerëzore brenda nje shoqërie dhe ka ndikuar më tej në biologjinë e tyre.

Kapaciteti i hershëm njerëzor për të mësuar nga të tjerët prodhoi shumë risi kulturore, si zjarri, gatimi, kontejnerët e ujit, njohuritë mbi bimët, armët, të cilat nga ana e tyre nxitën zgjerimin e trurit tonë dhe ndryshuan fiziologjinë, anatominë dhe psikologjinë tonë në mënyre vendimtare.



Pra ndryshe nga cdo specie tjetër ne njerëzit jemi specie kulturore.

Normat kulturore edhe shoqërore që shqiptarët kanë mësuar, përvetësuar dhe zbatuar gjatë gjithë historisë së tyre kane pasur një theks të fuqishëm tek interesat individuale, që për disa vazhdojnë të drejtohen nga qëllimi i

thjeshtë e bazik i mbijetesës, ndërsa për të tjerë nga lakmia e pangopur për privilegje, pasuri, pushtet e kontroll. Për më tepër, duke theksuar “unë” pothuajse tërësisht në kurriz të “ne”, besimi ynë injoron faktin që njerëzit janë thelbësisht social duke na drejtuar drejt profecive vetëpërbushëse.

Pra paaftësia jonë për të vepruar

ndryshe, është përcaktuar nga kapaciteti ulët për të formuar një shoqëri bashkëpunuese ndaj edhe krizat me të cilat përballemi përkeqësohen dhe duket se po përjetesohen.

Sërisht sot gabimisht po supozojmë se sapo të vendoset një regjim i sundimit të ligjit, ai do të jetë i vazhdueshëm dhe i vetëqëndrueshëm.

Kushtetuta në vetvete, ligjet apo të gjithë instucionet ligjzbatuese nuk mund të garantojë një shoqëri kohezive, madje të kundërtën e kemi provuar disa herë.

Ajo që sot duhet të pranojmë është pa një shoqëri kohezive ku njerëzit të kujdesen për të mirën e përbashkët krahas interesit personal, kushtetutat ligjet instucionet mund të bëhen jashtëzakonisht të brishta, aq me tepër kur udhëheqësit populistë nxitojnë të mbushin boshllëkun me vlera të paqëna misionarësh e reforma të dështuara duke nxitur vetëm polarizimin.

Inteligjenca e secilit prej nesh, nuk qëndron në trurin individual, por në mendjen kolektive të cilën At Zef Pëllumbi mendonte se shqiptarët duhet ta ndryshonin.

Por për këtë duhet të pranojmë që për të funksionuar, secili prej nesh mbështetet jo vetëm në njohuritë e ruajtura brenda kokës sonë, por edhe në njohuritë e ruajtura, në mjedis dhe veçanërisht te njerëzit e tjerë anëtarë të së njejtës shoqëri.



Skano

**NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
The Albanian
MBI 1 000 000
NDJEKES**

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Akoma nuk jeni
regjistruar
në Google?

NA KONTAKONI

Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT



Vendoseni
biznesin tuaj
ne rrjetin e
bizneseve ne UK

020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545

EDHE NË RASTIN MË TË MIRË TË PARASHIKUESH-MËRISË SË ADMINISTRATËS SË ARDHSHE AMERIKANE, VITET 2025-2029 NUK PRITET TË JENË KTHESË HISTORIKE DREJT PAQES, POR PJESË E NJË PËRSHKALLËZIMI GJITHNJË E MË TË MADH GLOBAL. ATY DO TË GJENDET EDHE BALLKANI PERËNDIMOR, SI "UNFINISHED BUSINESS"

VETON SURROI

1.

Ekziston një cikël natyral vendimarrjeje në botën perëndimore dhe të atyre që e vëzhgojnë me vëmendje, e ai cikël thotë se në vitin e zgjedhjeve amerikane nuk mund të merren vendime me rëndësi në marrëdhënie ndërkombëtare. Përjashtim dukeshin muajt e fundit të administratës Clinton, kur u mendua se ishte krejtësisht afër paqja mes Palestinës e Izraelit, por fakti që nuk u arrit është mu dëshmi e rregullit.

Laptop Hp 16-D1033ns 16,1" I7-12700h 16 Gb Ram 512 Gb Ssd Nvidia Geforce Rtx 3060 Spanish QwertyIf You'Re Passionate About It And Electronics, Like Being Up To Date On Technology And Don'T Miss Even The Slightest Details, Buy Laptop Hp 16-D1033ns 16,1" I7-12700h 16 Gb Ram 512 Gb Ssd Nvidia Geforce Rtx 3060 Spanish Qwerty At An Unbeatable Price. Processor Family: Intelintel Core I7speed: 4800 Mhz10/100/1000 Mbpsproduct With Plug: Yestype Of Plug: Plug Euconnections: Usb-A 3.2usb-Crj45mini Displayportusb 3.2hdmi 2.1thunderboltthdmieternet Lanhdmi 2.1 X 1usb-C 3.2 Gen 1 (3.1 Gen 1)3.5mm Jack Cabletype: Laptopddr5numeric Keyboardtouchpadfull Kayboardssddr5-SDRAMkeyboard: Spanish Qwertyprocessor: I7-12700hdiagonal Of The Screen (Cm): 40,9 Cmconnectivity: Wi-Fi 6 Ghzbluetoothmiracastbluetooth 5.2approx. Charging Time: 30 Minutesnot Included: Operating Systemoptical Drivemobile Network Connectionresolution (Px): 1920 X 1080 Pxoperating System: Without Operating Systemwindows 11 Home-resolution: Full Hdcharacteristics: Backlightedfront-Facing Cameraintegrated Microphonebuilt-In Microphonecard Reader2 Speakersbuilt-In Graphics Adaptercolour: Blackscreen: 16,1"Ram Memory: 16 Gb Ramhard Drive: 512 Gb Ssdgraphics Card: Nvidia Geforce Rtx 3060country/region Of Manufacture: Chinaaspect Ratio: 16:9power: 35 Wcompatible Memory Cards: Sdtechnology: Ledipsmimevt-Dvt-Xexecute Disable Bit (Xd Bit)Standard: Ntscrechargeable Lithium Battery: 70 Whrecommended Use: Gamingformat: M.22 X 8 Gbsound: Bang & Olufsentouchscreen: Nocamera: HdLuminous Flux: 250 Lmform Factor: So-Dimadapter Ac: 200 Wmemory Type:



Gddr6chipset: Intel Soccertificate: Energy Star Certificatecompatible: Pci Express, Nvmeincludes: Ssd X 1frequency: 4,7 Ghzbattery Type: Litio Ionnuclui: 14 Nucleigraphic Driver: Intel Iris Xe Graphicsgraphics Memory Capacity: 16 Gbuk-go.kelkoogroup.net>

Këtë leksion e mësoi Kosova në lëkurë të veten në shtator të vitit 2020. Asokohe kryeministri Hoti dhe presidenti Vuçiq u ftuan në Washington për të nënshkruar në zyrën e presidentit Trump, dy muaj para zgjedhjeve amerikane, Marrëveshjen për normalizimin ekonomik mes dy vendeve. Prej asaj kohe kanë kaluar katër vjet dhe marrëdhëniet mes dy vendeve janë çdo gjë pos normale.

E Kosova nuk ka kaluar më së keqi. Asokohe Sudani u bë pjesë e "Marrëveshjeve abrahamike" që synonin paqen në Lindjen e Mesme, bazuar në normalizimin e marrëdhënieve me Izraelin. Sot Sudani ka mbi një vit luftë qytetare me dhjetëra mijëra të vrarë dhe mbi shtatë milionë refugjatë. Rregulli pra thotë që do pritur presidentin e zgjedhur amerikan.

Dhe, njëra prej arsyeve pse nuk ekziston ndonjë lëvizje serioze kah paqja - në luftën e Rusisë kundër Ukrainës, luftës së Izraelit kundër palestinezëve në Gazë dhe Breg Perëndimor apo në marrëdhëniet Kosovë-Serbi - është në

një masë të rëndësishme e lidhur me pritjen e zgjedhjes së presidentit amerikan.

2.

Zgjedhjet amerikane, ndërkaq, kanë një shkallë të lartë ndërlikueshmërie dhe një shkallë të lartë thjeshtësie njëkohësisht. Pjesa e ndërlikuar ka të bëjë me kufijtë e paparashikueshmërisë, të cilët po preken çdo ditë. Është gjithnjë e më e paparashikueshme gjendja psiko-fizike e një presidenti Biden me mandat të dytë. Dhe është gjithnjë e më e paparashikueshme gjendja psiko-fizike e një presidenti Trump me mandat të dytë - shtu këtu edhe faktin se tashmë është shpallur nga juria në New York si shkelës ligji dhe do të jetë kandidati i parë presidencial i dënuar për veprime kriminale që merr pjesë në garë e me gjasë për të qenë edhe i zgjedhur president.

Pjesa e thjeshtë apo interpretimi i thjeshtësuar është krejtësisht i ndryshëm me atë të ndërlikuarin. Pra, zgjedhjet amerikane janë zgjedhje mes dy parashikueshmërive. Zgjedhja e presidentit Biden për mandat të dytë do të thoshte vazhdim i përcaktimeve të deritanishme në politikën e jashtme. Pra, nga aspekti strategjik, kjo do të thoshte pozicionim të mëtejshëm në garën globale gjeopolitike me Kinën, përkrahje Ukrainës kundër Rusisë, përkrahje Izraelit kundër të gjithë kundërshtarëve të vet, përpjekje për krijimin e një aleance të vendeve

sunite të Gjirit arabik kundër Iranit.

Zgjedhja e presidentit Trump për mandat të dytë do t'i thoshte të gjitha këto si tek administrata Biden, por me një tonalitet më të madh force. Siç shpjegon këshilltari i fundit për siguri kombëtare, Robert C.O'Brien, në artikullin e "Foreign Affairs", administrata e ardhshme Trump do të niset nga maksima romake "Si vis pacem, para bellum", "Nëse do paqe, përgatitu për luftë". Sipas O'Brien, presidenten Trump do të fuste tarifa 60 për qind për prodhimet kineze, do të zhvendoste pjesën më të madhe të flotës së vet detare në Paqësor, do të ndëshkonte Iranin ku të jetë e mundur dhe do të forconte përkrahjen për Ukrainën.

Dhe, ndonëse O'Brien shpjegon se do të forcohej bashkëpunimi me vendet e NATO-s, ai njëkohësisht e përshkruan administratën e ardhshme si një "realizim jacksonian", të quajtur ashtu sipas presidentit të parë populist Andrew Jackson, i cili pos spastrimit etnik të indianëve në Florida njihet, sipas profesorit Walter Russell Mead, si politikë të "marrjes së vendimeve të politikës së jashtme bazuar vetëm në interesin kombëtar dhe nderin kombëtar, duke mos pasur asnjë shqetësim për përdorimin e forcës maksimale ushtarake duke minimizuar humbjen e jetëve amerikane".

3.

Në Amerikë kjo do të quhej "more of

the same, only more so", që në shqip do të ishte "më shumë nga e njëjta gjë, vetëm se më shumë". Dhe, një gjë e tillë do të vlente po të ishte e parashikueshme paparashikueshmëria e një presidenti Trump në mandat të dytë, të çliruar tashmë nga të gjitha konvencionet e traditës presidenciale amerikane.

Por, edhe në rastin më të mirë të një presidence Biden si vazhdimësi e mandatit të parë apo të një presidence Trump që do të ishte platforma O'Brien, një shkallë më e lartë konfliktuoziteti global, vitet 2025-2029 nuk duken si periudha kthesash historike drejt paqes. Më shumë duken si përshkallëzim në një periudhë të re ende të papërcaktuar marrëdhëniesh ndërkombëtare që tashmë kanë dy pole superfuqish, SHBA dhe Kina, por kanë edhe fuqi të tjera tradicionale (evropiane) apo ato në zhvillim e sipër (aziatike, afrikane) që e bëjnë botën multipolare gjithnjë e më të ndërlikuar.

Në këtë botë të ndërlikuar lufta në Ukrainë mund të ndalet pas zgjedhjeve amerikane, për shembull, me një armëpushim. Kushtet e armëpushimit, ndonëse nuk flitet për marrëveshje paqeje, do të japin skicën e një ardhmërie që po ndërtohet. Para dy vjetësh, nga draftet e negociuara e tashmë të botuara në "The New York Times", del se që arritur pak a shumë përcaktimi i Ukrainës si një shtet neutral e nën garancinë e Pesëshës së madhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Fakti që draftet dolën në publik njëkohësisht me mbajtjen e Konferencës së Paqes për Ukrainën në Zvicër, janë pjesë e përgatitjes për një zhvillim të logjikshëm që rrjedh nga fushëbeteja, pamundësisë së asnjëris palë për të arritur objektivat e veta të plota ushtarake.

Krahas Ukrainës, arritja e një armëpushimi në Gazë do të duhej të ishte hyrje për një iniciativë më ambicioze diplomatike amerikane (tashmë pothuajse të dakorduar me Arabinë Saudite) për një rirreshtim të vendeve arabe në gjeostrategjinë e madhe ndaj boshtit të perceptuar Kinë-Rusi-Iran.

4.

Po të jenë këto zhvillimet, atëbotë do të hynim në një katërvjeçar të ri të zonave të konflikteve të papërfunduar. Për ne në kontinentin evropian, kjo zonë do të fillojë në vijën e armëpushimit Ukrainë-Rusi e të shtrihet deri në Bosnjë-Hercegovinë.

Ballkani Perëndimor kështu do të hyjë në agjendën e cilitdo që të zgjidhet si president amerikan, si "unfinished business", në hartën gjithnjë e më të madhe krizash.

REL

ÇFARË E LIDH TË DJATHTËN EKSTREME NGA SERBIA DHE BE-NË

Kundër migrantëve dhe vlerave liberale, për bashkëpunim më të ngushtë me Rusinë. Kjo është mënyra më e shkurtër për t'i përshkruar partitë e ekstremit të djathtë që hynë në Parlamentin Evropian, pas zgjedhjeve që u mbajtën në fillim të qershorit.

Me shumë prej tyre, partitë ultra të djathta në Serbi, por edhe Partia Përparimtare Serbe (SNS) në pushtet kanë kontakte prej vitesh.

“Unë pres regres të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore brenda Serbisë, e cila është inkurajuar nga rritja e së djathtës ekstreme në Evropë”, thotë për Radion Evropa e Lirë Izabella Kisiq, drejtore ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Edhe pse Partia Popullore Evropiane (EPP) – një grupim konservator i partive të qendrës së djathtë në Parlamentin Evropian – fitoi sërish numrin më të madh të vendeve dhe pritet të formojë shumicën, e djathta ekstreme shënoi rezultat të lakmueshëm në vendet më të mëdha të BE-së.

Në Francë, Tubimi Kombëtar i ekstremit të djathtë fitoi 30 vende në Parlamentin Evropian – dy herë më shumë se koalicioni i udhëhequr nga Rilindja e presidentit Emmanuel Macron – gjë që çoi edhe në shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme.

Në Gjermani, Alternativa për Gjermaninë (AfD) zuri vendin e dytë sa i përket numrit të mandateve të fituara. Autoritetet gjermane e klasifikojnë këtë parti si “organizatë ekstremiste” dhe në disa lande federale është nën vëzhgimin e Shërbimit për Mbrojtjen e Rendit Kushtetues.

“Miqte nga Gjermania”

Për partinë joparlamentare nga Serbia, Zavetnici – kryetarja e së cilës, Milica Gjurgjeviq Stamenkovski, është ministre për Përkujdesje ndaj Familjes në Qeverinë e Serbisë – AfD-ja përfaqëson “opcionin kryesor sovranist të shtetndërtimit në Gjermani”.

Gjurgjeviq Stamenkovski, si kryetare e partisë Zavetnici, u takua në nëntor të vitit 2023 në Bundestag me kryetarin e AfD-së, Tino Chrupalla.

Në atë takim, siç u njoftua, ata u shprehën kritikë ndaj politikës së presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe shkëmbyen mendime për “krizën e thellë të Bashkimit Evropian”.

Zavetnici u formua në vitin 2012, pasi disa anëtarë u larguan nga Partia Radikale Serbe, president i së cilës atëkohë ishte Vojislav Sheshel, i dënuar për krime lufte nga Tribunali i Hagës.

Zavetnici nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe kërkon anulimin e Mar-



rëveshjes së Brukselit, të nënshkruar nga Kosova dhe Serbia në vitin 2013, me qëllim normalizimin e marrëdhënieve.

Në fushatën për zgjedhjet parlamentare në Serbi, të mbajtura në fund të vitit 2023, partia deklaroi vazhdimisht se e dënon “ideologjinë dhe propagandën e komunitetit LGBT”.

Kontakte me AfD-në, prej vitesh, mban edhe lëvizja ultra e djathtë serbe, Dveri. Sikurse Zavetnici, as kjo parti nuk e kaloi pragun zgjedhor në zgjedhjet e dhjetorit.

Kryetari i saj i deritashëm, Boshko Obradoviq, i cili u largua nga partia pas rezultatit të dobët në zgjedhjet parlamentare të dhjetorit, filloi kontaktet me AfD-në qysh në vitin 2017.

Kur ultra të djathtët gjermanë hynë në Bundestag në shtator të atij viti – për herë të parë që nga viti 1945 – Obradoviq i uroi ata.

“Urime miqve të mi nga Alternativa për Gjermaninë. Shihemi në Bundestag dhe Beograd. Le të vazhdojmë. Është koha për Alternativën për Serbinë”, shkroi Obradoviq në Twitterin e atëhershëm.

AfD-ja u përgjigj duke e mbështetur Obradoviqin në zgjedhjet presidenciale të vitit 2017 në Serbi, edhe pse kjo nuk e ndihmoi shumë, pasi ai fitoi vetëm pak më shumë se dy për qind të votave.

Në vitet në vazhdim, delegacioni i Dverit ishte disa herë në Gjermani.

Në dhjetor të vitit 2019, Obradoviq, së bashku me kolegen e tij partiake, Dragana Trifkoviq, vizituan Bundestagun.

Në kumtesën e publikuar nga partia serbe pas vizitës u tha se dy partitë i lidhin tema të shumta, e para së gjithash trashëgimia e krishterë e Evropës, vlerat familjare dhe zgjidhja e krizës së migrantëve.

“Të gjitha këto janë tema për të cilat ne do t'i vazhdojmë diskutimet jo vetëm me Alternativën për Gjermaninë, por edhe me kolegë të tjerë evropianë nga opsionet politike konservatore, me të cilët ndajmë shumë mendime të ngjashme, pavarësisht se nuk jemi dakord për të gjitha temat”, tha atëkohë Obradoviq.

Derisa ishte në krye të Dverit, Obradoviq vazhdimisht mbështeste tezën se Qeveria në Serbi dëshiron ta popullojë vendin me migrantë dhe refugjatë nga Lindja e Mesme dhe Afrika dhe se në këtë mënyrë “dëshiron ta zgjidhë problemin me natalitetin e ulët”.

Në vitin 2019, partia e tij nisi një petition kundër, siç u tha, politikave për migrantë të autoriteteve republikane dhe lokale.

Përveç politikës së saj kundër migrantëve, lëvizja Dveri njihet edhe për politikën e saj anti-LGBT.

Që nga viti 2009, shumë kohë përpara se të hynte në politikë, Dveri organizoi disa herë të ashtuquajturën “Shëtitje familjare”.

Tubimi organizohej fillimisht në

Beograd, e më pas edhe në disa qytete të tjera të Serbisë, në prag të Paradës së Krenarisë, të cilën e organizojnë organizatat e LGBT-së, me qëllim shpërfaqjen e problemeve me të cilat ballafaqohet ky komunitet.

Inkurajim për të djathtët serbe Izabella Kisiq beson se sukcesi i ekstremit të djathtë në Evropë do të jetë një inkurajim për partitë e spektrit të djathtë dhe të ekstremit të djathtë në Serbi, të cilat përgjithësisht janë proruse.

“Aty ku Serbia bashkëpunon më së miri me Rusinë – e tani do të ketë partnerë të forcuar edhe në Evropë – është qëndrimi i saj ndaj të drejtave të njeriut, vlerave liberale dhe atyre që janë themele të BE-së”, thotë Kisiq.

Në të njëjtat zgjedhje presidenciale në të cilat AfD-ja mbështeti Boshko Obradoviqin, Markus Frohnmair, deputet i AfD-së në Bundestag, foli në një tubim parazgjedhor të Lëvizjes për Lirinë Popullore – një parti e vogël joparlamentare nga spektri i djathtë, e themeluar nga ish-anëtari i Dverit, Miroslav Paroviq.

Lidhjet me Rusinë Izabella Kisiq thotë se partitë ultra të djathta në Evropë jo vetëm se kanë qëndrim pozitiv ndaj Kremlinit, por ka raportime edhe për lidhjet e tyre financiare.

“Ka, gjithashtu, raporte të shumta se Kremlini e ka mbështetur financiarisht fushatën e Marine Le Penit [nga Tubimi Kombëtar] në Francë”, thotë Kisiq.

Në qershor të vitit 2023, komiteti hetimor i Asamblesë kombëtare franceze për ndërhyrjen e huaj vuri në dukje lidhjet ideologjike midis Tubimit Kombëtar dhe udhëheqjes ruse.

Tubimi Kombëtar ka marrë më herët kredi nga kompania ruse, Aviazapchast S.A., të cilën kundërshtarët e tij e kanë interpretuar si një shenjë të lidhjeve të kësaj partie me Rusinë.

Pasi Rusia filloi pushtimin e Ukrainës në shkallë të plotë në vitin 2022, kryetari i Tubimit Kombëtar, Jordan Bardella, dhe anëtarë të tjerë të kësaj partie në Parlamentin Evropian votuan për një rezolutë të BE-së që e dënon agresionin rus kundër Ukrainës. Megjithatë, në nëntor të vitit 2022, ata abstenuan nga votimi për të ofruar ndihmë financiare për Ukrainën.

Tubimi Kombëtar kërkon kufizimin e lëvizjes së lirë të migrantëve, duke zbatuar kontrolle në kufijtë kombëtarë, si dhe bën thirrje për tërheqje nga marrëveshjet e Bashkimit Evropian për klimën.

Kisiq thotë se rritja e së djathtës ekstreme në Bashkimin Evropian nuk ka ndodhur papritur.

“Është një proces i gjatë që ka zgjatur për më shumë se një dekadë”, thotë Kisiq dhe shton se pas pushtimit rus të Ukrainës, çështja e të drejtave të njeriut është gjithnjë e më pak në fokus të Bashkimit Evropian – gjë që, sipas saj, i përshtatet ekstremit të djathtë.

“Tani, siguria e Evropës është në radhë të parë. Kam frikë se, në këtë aspekt, autoritetet do t'i mbyllin sytë para shkeljes së të drejtave të njeriut, jo vetëm në Serbi, por në të gjithë BE-në”, thotë Kisiq.

Sipas saj, çështja kryesore tani është se cili do të jetë rezultati i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Francë, të cilat do të mbahen më 30 qershor dhe 7 korrik.

“Unë do të thosha se jo vetëm opozita ultra e djathtë [në Serbi], por edhe Qeveria aktuale e djathtë presin që të ketë ndryshime në disa vende të BE-së, kryesisht në Francë. Kjo, jo vetëm se do t'i dobësonë thirrjet për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian, por do të hapte rrugë për një bashkëpunim më të fortë mes atyre vendeve individuale evropiane, Kremlinit dhe Serbisë. Kjo është diçka nga e cila përfiton politika proruse në Serbi”, përfundon Kisiq./REL

1938/ The Washington Post: Rrëfimi i Gerald G. Gross për Faik Konicën

“The Washington Post” ka botuar, të dielën e 13 shkurtit 1938, në faqen n°4, një rrëfim asokohe për Faik Konicën nga gazetari amerikan Gerald G. Gross, të cilin, Aurenc Bejta, nëpërmjet blogut të tij “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Ministri Konica, i Shqipërisë, mbetet beqar; Pasionet e tij janë muzika, teatri dhe filologjia

Nga Gerald G. Gross

Në mesin e shefave të misionit në Uashington, beqarët janë po aq të rrallë sa burrat në mëngjes. Ata mund të numërohen me gishtat e njëres dorë, zbulon një sondazh i shpejtë dhe beqari më i paprekshëm nga të gjithë duket se është ministri shqiptar Faik Konica.

“Gjithmonë e shtyj për vitin e ardhshëm”, thotë ambasadori me zë të butë, të cilit iu desht të bënte një deklaratë zyrtare një muaj më parë për të shuar zërat se ai dhe një balerinë amerikane kishin synime martesore. “E vërteta është se nuk do të martohem kurrë.”

Ai nuk jep arsytet e tij dhe askush nuk e ka pyetur, por mund të supozojmë se ai e kupton se gratë nuk mund t’i durojnë sënduket e librave të stërm-bushur me libra, fonografë kolosale në dhomën e ndenjes dhe dorëshkrime të shpërndara në të gjithë ambientet. Lulet e portokallisë, pranon ai, kanë vendin e tyre, por lërinin atij bibliotekën e tij, muzikën e tij, bojë dhe të drejtën e pakundërshtueshme për t’i shijuar kur dhe si të dojë.

Plumbi nga këmbanat e dasmës (varianti B, nëntipi 2) ishte i pashmangshëm për këtë tip të veçantë, jo vetëm për shkak të zgjedhshmërisë së ministrit Konica dhe romancës së sipërpërmendur të gazetës, por për shkak se Shqipëria, për të cilën pak dëgjohet ndonjëherë, është bërë material në faqen e parë që nga Mbreti Zog I, javën e kaluar njoftoi fejesën e tij me konteshën hungareze Apponyi, nëna e së cilës është e lindur amerikane.

E gjithë kjo na çon në një pikë tjetër, dhe më pas do të trajtojmë një taktikë të re. Ligji i ndalon diplomatët shqiptarë që të martohen me të huaj. Megjithatë, asnjë kufizim i tillë nuk duket se e shqetëson monarkun, edhe pse ai, një mysliman, dhe nusja e ardhshme duket se janë në mes të ndërlikimeve fetare. Kjo nuk duket si kriket, veçanërisht duke pasur parasysh që diplomati në Uashington, i cili është i martuar me një grua fshatare, është përjashtim dhe jo rregull.

Faik (shqiptohet Fi-eek) Konica është një njeri që do dhe urren shumë. Në kategorinë e parë mund të përmendim kërkimet filologjike, teatrin, muzikën klasike, ushqimin dhe pijen e mirë,



shkrimin krijues dhe vetminë. Aversionet (neveritë) e tij janë turmat, ushtrimet, kafshët, ritmet e xhazit, mashtrimet e shoqërisë dhe bisedat me zë të lartë.

I pyetur për të shkruar një portret të tij për këtë artikull, ai shkroi :

“Edhe pse ka një mospëlqim të fortë ndaj turmave dhe distanca prej tyre është vënë re si karakteristikë e tij kryesore, Faik Konica ka treguar gjithmonë një simpati të vërtetë për masat. Në vitin 1930 ai iu lut mbretit Zog që të shqyrtonte një projekt për rishpërndarjen e tokës në Shqipëri dhe projekti u mishërua shpejt më pas në një reformë gjithëpërfshirëse agrare, e cila, pas një debati të gjatë në parlamentin kombëtar, u bë ligj.

I vetëdijshëm për karakterin e tij të rezervuar, ndonëse nuk është as i turpshëm dhe as i turpëruar, të afërmit e konsiderojnë “asket”. Ai shprehet qartësisht i matur për moshën e tij, por vlen të përmendet se shumë nga kolegët e tij ministra dhe ambasadorë gjithashtu preferojnë të heshtin për këtë temë. Ai nuk është kthyer në shtëpi prej gjashtë vitesh, sepse vizita të tilla “e bëjnë atë të rraskapitet fizikisht”.

Vëllezërit diplomatë le të golfojnë, të kalërojnë, të ecin sipas dëshirës së tyre, por çdo formë e ushtrimit fizik është mallkim për zotin Konica. Kjo neveri, si dhe neveria e tij ndaj kafshëve shtëpiake, ndoshta do të ishte e kuptueshme për një psikanalist, kur mëson se një kal e hodhi në tokë Faikun 15-vjeçar dhe e detyroi të mbante paterica për një vit. Sot, ai i

urren kuajt, qentë dhe macet. Qentë, mendon ai, janë shumë servilë dhe macet shumë të pavarura.

“Ndoshta nëse do të kishte një krijesë shtëpiake, prirja e së cilës do të ishte midis asaj të qenit dhe asaj të maces, unë do të kisha një të tillë,” thotë ai.

I dërguari nga Tirana në Uashington ka lindur në qytetin e Konicës, nga i cili ka marrë edhe emrin familja, në kufirin e Shqipërisë dhe Epirit grek. Babai i tij ishte një pronar i madh tokash, që i përkiste një prej 30 familjeve feudale, të cilat për disa shekuj me radhë kanë formuar klasën sunduese të këtij rajoni malor që shtrihet në bregun perëndimor të gadishullit Ballkanik. Stërgjyshi i tij ishte mik i ngushtë i Sir Hudson Lowe, në atë kohë Guvernatori i Ishujve Jon, dhe i destinuar të bëhej i famshëm si guvernator i Shën Helenës dhe kujdestar i Napoleonit. Ndër veprat që ministri po përgatit për botim është edhe vëllimi i korrespondencës mes paraardhësve të tij të shquar dhe anglezit të titulluar.

Ministri Konica studioi në kolegjin jezuit në Shkodër (Shqipëri), në Liceun Perandorak në Kostandinopojë dhe në Francë. Në vitin 1909 ai erdhi fillimisht në Shtetet e Bashkuara për të propaganduar për autonominë shqiptare brenda Perandorisë Osmane, për të ndihmuar refugjatët atje dhe për të studiuar për Masterin e Arteve në Filologjin Romantike në Universitetin e Harvardit.

Njerëzit e tij, mjaft të kënaqur me

regjimin e Kostandinopojës, shpresonin se ai do të hynte në l’Ecole des Sciences Politiques në Paris me synimin për të shërbyer në trupin diplomatik të Sulltanit. Por Konica i ri, i shtyrë nga zelli i çlirimtarit, sapo kishte marrë diplomën e tij bachelor në Francë, ai filloi lëvizjen nacionaliste shqiptare të krijuar për të siguruar autonominë nga sulltani. Megjithëse në fillim ishte i moderuar, programi i zemëroi aq shumë autoritetet osmane, saqë tokat e themeluesit të tij u konfiskuan dhe ai u dënua me vdekje — në mungesë.

Disiplina shërbeu vetëm për intensifikimin e lëvizjes, jo vetëm brenda por edhe jashtë saj. Ndërsa Konica po kërkonte mbështetje dhe simpati në këtë vend dhe ithtarët e kauzës po bënin të njëjtën lojë gjë në vende të tjera, rebelimet kundër sundimit osman po shuheshin në shtëpi (atdhe). Pika e kthesës erdhi në vitin 1912, kur u dha autonomia nga turqit dhe, më vonë në të njëjtin vit, pavarësia e Shqipërisë u shpall nga Ismail Qemal Vlora. Konica u emërua një nga delegatët e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, e cila, më 20 dhjetor 1912, njohu në parim pavarësinë e Shqipërisë. Shtatë muaj më vonë konferenca e shpalli Shqipërinë një shtet sovran të pavarur.

Në vitin 1925 Konica, si udhëheqës i opozitës Nacionaliste Liberale, këshilloi kundër një kryengritjeje të armatosur për të rrëzuar qeverinë e atëhershme konservatore, ku Ahmed Zogu sapo ishte zgjedhur president për një mandat shtatëvjeçar. Më pas, i diplomuari i Harvard-it me sy të zinj u nderua me emërimin si i dërguari i

parë në Shtetet e Bashkuara nga Shqipëria. Ai ia paraqiti letrat kredenciale Presidentit Coolidge në tetor 1926 dhe shërbimi i tij këtu ka qenë i vazhdueshëm.

Në lidhje me mbështetjen e tij për reformën agrare, ministri thotë :

“Pronarët e mëdhenj të tokave ishin të hidhëruar në denoncimin e tyre. Ata fajësuan Faik Konicën për tradhtinë e klasës së tij dhe lanë të kuptohet për hakmarrje të dhunshme. Por ligji nuk ishte i padrejtë, sepse parashikonte kompensim të plotë monetar për pronarët e tokave të rishpërndara, dhe pikërisht për këtë ligji nuk ka arritur ende në fazën e zbatimit, shteti nuk ka arritur ende të lirojë disa miliona të nevojshme për kompensim.”

Ministri shqiptar është ndoshta në fund të të pesëdhjetave, ka flokë të thinjura, të holla dhe me gjatësi mesatare. Beethoven, Mozart dhe Bach janë kompozitorët e tij të preferuar.

“Kur isha i ri, e doja Wagnerin, por tani më duken veprat e tij shumë të gjalla dhe të bollshme”, thotë ai.

Ai i shmang pritjet në radio, për shkak të muhabetëve reklamuese, por ndjek transmetimet javore të Toscanini-t që transmetohen aktualisht. Rezidenca dhe legata e tij janë të kombinuara në një apartament shërbimi të mobiluar thjesht në Hotel Mayflower

Në Amerikë janë 30.000 shtetas dhe 100.000 burra, gra e fëmijë me origjinë shqiptare. Shumica më e madhe e tyre janë të shpërndarë në një vend pak më i madh se Belgjika, me jo më shumë se 1.500.000 banorë.

Ministri Konica ka 2.500 libra në bibliotekën e tij këtu dhe po aq të tjerë në atdhe. Disa vizatime origjinale të Rodin-it zbukurojnë muret e dhomës së tij të gjumit. Ai ka njohuri të leximit të italishtes, spanjishtes, rumanishtes, portugalishtes, turqishtes, gjermanishtes, greqishtes së vjetër dhe moderne, latinishtes, hebraishtes dhe arabishtes, si dhe shqipes, frëngjishtes dhe anglishtes, të cilat i flet me lehtësi.

Ai pi në mënyrë diskrete dhe selektive dhe pi rrallë para darkës sepse nuk i pëlqen të ndërpresë pijen për t’iu përgjigjur telefonit ose për të kënduar (lexuar) një letër. Ai shqetësohet për ndikimin që ka duhani tek ai. Ai pi tre paketa cigare amerikane në ditë.

Filmat që ai i ndjek “vetëm kur nuk ka asgjë tjetër për të shikuar”, por le të përpiqet këdo që të mos e shohë “Borëbardhën!”

Akoma nuk keni një website?

MUND TE VINI NË ÇDO KOHE NË ZYRAT TONA

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

- ✓ BUSINESS CARDS
- ✓ BANNERS
- ✓ LOGO
- ✓ POSTERS
- ✓ VIDEO MARKETING

The Albanian

OFERTA SPECIALE

Dotech
websites 

KONTAKTONI

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

